

**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**  
**P.nr. 933/2013**

**10 korrik 2014**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Nuno Manuel Ferreira de Madureira si Kryetar i trupit gjykues dhe Gjyqtaret e EULEX-it Roxana Marilena Comsa dhe Iva Niksic si anëtare të trupit gjykues, me pjesëmarrje të Zyrtares ligjore ndërkombëtare Vera Manuello si procesmbajtëse, në lëndën penale P.nr. 933/2013

*Kundër*

**Ž. V.**, i biri i J. (babai) dhe M. (i vajzërisë J.), i lindur më \_\_\_\_\_ në M\_\_\_\_\_ dhe jeton në adresën \_\_\_\_\_ NN, i martuar, \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ i papunësuar. Ai është arrestuar më 29 korrik 2013 dhe është mbajtur nën masën e paraburgimit nga data 28 shkurt 2014 deri më 20 qershor 2014; aktualisht nën masën e paraqitjes në stacion policor;

*Akuzohet* sipas Aktakuzës së Prokurorit shtetëror në Mitrovicë të datës 24 tetor 2013 për veprën penale të:

“Tentim vrasjes së rëndë” në kundërshtim me nenin 147 paragrafi (1.10) në lidhje me nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës, UNMIK/REG/2003/25 (KPK);

*Pasi janë mbajtur* seancat kryesore, që të gjitha të hapur për publikun, më 06 maj, 03, 04, 09, 10, 11, 18, 19 qershor dhe 09 korrik 2014, në prani të të akuzuarit **Ž. V.** dhe avokatit të tij mbrojtës Nebojsa Vlajic, palëve të dëmtuara policit A. T. dhe policit F. S. (më 03 qershor 2014) dhe prokurorit shtetëror,

*Pasi janë informuar* palët më 09 korrik 2014 se Gjykata është e obliguar sipas kualifikimit ligjor të veprës penale siç përcaktohet me Aktakuzën e prokurorisë në përputhje me nenin 360 paragrafin (2) të KPP-së dhe se Gjykata mund që sipas detyrës zyrtare ta rikualifikojë veprën penale fillestare me një tjetër në bazë të fakteve që nuk

përputhen plotësisht me ato të përshkruara në Aktakuzë por të cilat nuk përbëjnë ndryshim thelbësorë të rrethanave,

*Pas informimit të mbrojtjes më 09 korrik 2014 për mundësinë e këtij rikualifikimi me kohë dhe për të drejtën e tij për të parashtruar çfarëdo vërejtje dhe për të paraqitur çfarëdo prove shtesë lidhur me këtë çështje,*

*Pas marrjes së informatës nga mbrojtja se nuk dëshiron që të parashtrojë kurrfarë provash shtesë por se ai do t'i paraqesë vërejtjet për kualifikimin juridik të veprës penale gjatë fjalës përmbyllëse,*

*Pas dëgjimit të fjalëve përmbyllëse të palëve më 09 korrik 2014,*

*Pas këshillimit dhe votimit nga trupi gjykues më 09 korrik 2014,*

*Duke u mbështetur në nenin 366 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP) më 10 korrik 2014 në seancën publike dhe në prani të të akuzuarit, avokatit të tij mbrojtës dhe prokurorit shtetëror;*

*Nxjerr këtë:*

## **AKTGJYKIM**

**I. I akuzuari Ž. V. është**

### **FAJTOR**

**Sepse** më 14 gusht 2010, Njësia Rajonale për Mbështetje Operacionale (ROSU) ka qenë duke e zbatuar një plan operacional të quajtur “\_\_\_\_\_” me qëllim të luftimit të kontrabandës ilegale të mallrave në veri të Kosovës.

Në një kohë të caktuar gjatë pasdites së vonshme para orës 19:00, në rrugën e Rudares mes Zveçanit dhe Mitrovicës, në afërsi të udhëkryqit të Manastirit të Skokolicës, dy policë në rroba civile e kanë ndaluar një auto-cisternë që shkonte në drejtim të Mitrovicës jugore me targa të regjistrimit \_\_\_\_\_. Shoferi i kamionit e ka pranuar se cisterna ishte e ngarkuar me naftë.

Destinacioni i ngarkesës në kamion ka qenë pompa e karburanteve \_\_\_\_\_, pronë e familjes së të akuzuarit dhe e udhëhequr nga vëllai i tij Z. V. për të cilin i akuzuari ka punuar rregullisht.

Shoferi i kamionit nuk ka qenë në gjendje që të paraqesë kurrfarë dokumentesh në lidhje me mallin të cilin e transportonte. Shoferi i kamionit pastaj është urdhëruar nga policët që t'i përcjell ata për në terminalin doganor në jug të Mitrovicës. Shoferi i kamionit ka shkuar te kamioni, ka hyrë në kabinë, por në vend se të ndizte motorin, ka kërcyer nga kamioni përmes derës së pasagjerit dhe ka ikur.

Në ndërkohë, një turmë ka filluar që të mblidhet në rrugë kah drejtimi i Zveçanit në afërsi të zonës dhe serbët e Kosovës kanë filluar që të protestojnë kundër veprimeve të policëve shqiptarë të Kosovës. Në ndërkohë, rreth orës 19:00, pas kërkesës për asistencë, dy ekipe të ndara të uniformuara të policëve të ROSU-së kanë arritur në vendin e ngjarjes për t'i ndihmuar kolegët e tyre.

Palët e dëmtuara \_\_\_\_\_ A. T. dhe F. S., të veshur \_\_\_\_\_, janë vendosur në afërsi të pjesës së prapme të kamionit me qëllim të rregullimit të trafikut të qarkullonte, duke e ndalur trafikun që vinte nga Zveçani.

Disa minuta pasi shoferi i kamionit ka ikur, dhe derisa policët A. T. dhe F. S. po qëndronin në mes të rrugës, një motoçikletë me katër rrota (kuad) ka ardhur nga drejtimi i Zveçanit dhe është afruar me dy persona në të. I akuzuari **Z. V.** ka qenë shoferi. Identiteti i pasagjerit mbetet i panjohur.

I akuzuari është urdhëruar nga \_\_\_\_\_ A. T. që të ndalet duke e ngritur dorën e tij sipër kokës me shuplakën të kthyer drejtë. Me të kuptuar se shoferi i motorit nuk po ndalej, \_\_\_\_\_ i ka dhënë shenjë shoferit që të ngadalësojë.

I akuzuari i cili qartë i ka parë shenjat dhe i cili ka qenë plotësisht i vetëdijshëm se është dashur që t'u përmbahet urdhrave të \_\_\_\_\_, përkundrazi ka vazhduar që të ngasë me të njëjtën shpejtësi në drejtim të \_\_\_\_\_ A. T. dhe F. S..

\_\_\_\_\_ A. T. dhe F. S. kanë mundër që të shmangin ndeshjen me mjetin që vinte duke lëvizur me shpejtësi anash. Kështu, motoçikleta ia ka dalë që të kalojë tutje.

Pasi ka vazhduar ngasjen për disa metra drejt Mitrovicës, i akuzuari ka bërë një gjysmërreth dhe është kthyer prapa duke iu afruar kamionit dhe ka pyetur për veprimet e policisë në lidhje me kamionin.

Disa çaste më vonë, i akuzuari është arrestuar pranë kabinës së kamionit, dhe kështu është penguar nga kryerja e veprimeve të tjera, ndërsa pasagjeri i motoçikletës ia ka dalë që të ikë.

I akuzuari ka vepruar me dashje me qëllim që të pengojë kamionin së bashku me mallin në të që të dërgohet në terminalin doganor në jug të Mitrovicës dhe për t'iu nënshtruar procedurave doganore. I akuzuari ka qenë i vetëdijshëm se kamioni ka qenë nën ndalim policor dhe se personat në drejtim të të cilëve ka ngarë motoçikletën kanë qenë \_\_\_\_\_ duke vepruar në atë cilësi. I akuzuari po ashtu ka qenë i vetëdijshëm se ngarkesa e kamionit ka qenë e destinuar për pompën e derivateve \_\_\_\_\_ dhe se kamioni ishte ndaluar nga policët shqiptarë të Kosovës.

I akuzuar ka pasur aftësi të plotë mendore.

**Prandaj,**

**Gjykata e rikualifikon veprën penale të “Tentim Vrasjes së Rëndë” dhe**

**I akuzuari Ž. V. DËNOHET për kryerjen e veprës penale të tentimit për “Pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrës zyrtare” në kundërshtim me nenin 316 paragrafët (1), (3) dhe (4) të Kodit Penal të Kosovës (KPK), në përputhje me nenin 3 paragrafin (1) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës – Ligji 04/L-082 (KPRK);**

**II. I akuzuari Ž. V. është**

### **I PAFAJSHËM**

Sepse nën rrethanat e përshkruar më sipër, i akuzuari më datë 14.8.2010 rreth orës 19:00 në rrugën mes Zveçanit dhe Mitrovicës, në afërsi të udhëkryqit të Manastirit të Sokolicës, ka ngarë një motoçikletë me katër rrota në drejtim të palëve të dëmtuara të cilët janë përpjekur për ta ndaluar. Megjithatë, nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ai e ka përdorur mjetin e tij me dashje si armë vdekjeprurëse për t'i vrarë palët e dëmtuara apo se e ka shikuar mundësinë se për t'i goditur dhe ato dhe se mund të ishin vrarë si rezultat i këtij veprimi dhe ai është pajtuar me këtë.

**Prandaj, i akuzuari Ž. V. LIROHET nga kryerja e veprës penale të “Tentim Vrasjes së Rëndë” në kundërshtim me nenin 147 paragrafin (1.10) në lidhje me nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), sipas nenit 364 paragrafi (1) nën-paragrafi (1.3) i KPK-së.**

### **III. I akuzuari Ž. V.**

#### **DËNOHET**

me **12 (dymbëdhjetë) muaj burg** në përputhje me nenin 38 paragrafin (1) dhe nenin 65 paragrafin (2) të KPK-së.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 29 korrik 2013 deri më 28 shkurt 2014 dhe nën arrest shtëpiak nga data 28 shkurt 2014 deri më 20 qershor 2014 do të përfshihet në dënimin me burg sipas nenit 73 paragrafët (1) dhe (4) të KPK-së.

**IV.** I akuzuari do të paguajë 300 (treqind) euro në emër të shpenzimeve të procedurës penale, por lirohet nga detyra që të kompensojë shpenzimet tjera në përputhje me nenin 453 paragrafët (1) dhe (4) të KPP-së. I akuzuari duhet të paguajë shumën e urdhëruar jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data kur ky Aktgjykim merr formën e prerë.

#### **ARSYETIM**

### **I. PROCEDURA, KOMPETENCA E GJYKATËS, PROVAT**

#### **1.1. Ecuria procedurale**

1. Më 25 tetor 2013, Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës ngriti Aktakuzën PP nr. 157/2013, datë 24 tetor 2013, kundër të Akuzuarit **Ž. V.** e posedimit të paautorizuar të armëve”, në kundërshtim me nenin 374 paragrafi (1) të Kodit të ri Penal të Kosovës (KPRK) dhe “vrasjes së rëndë në tentativë”, në kundërshtim me nenin 147 paragrafi (1.10), lidhur me nenin 20 të KPK-së.
2. Më 13 nëntor 2013, u mbajt shqyrtimi fillestar lidhur me Aktakuzën, sipas nenit 245 të KPP-së, në të cilin i Akuzuari u vetë-deklarua fajtor për veprën e “pronësisë, kontrollit ose posedimit të paautorizuar të armëve”. Kjo u veçua nga procedura aktuale me Aktvendim gojor të Gjykatës Themelore të Mitrovicës më 13 nëntor 2013 në shqyrtimin fillestar të Aktakuzës. I akuzuari u vetë-deklarua i pafajshëm për veprën penale të “vrasjes së rëndë në tentativë” gjatë të njëjtit shqyrtimi fillestar të Aktakuzës.
3. Në pajtim me nenin 245 paragrafi (5) të KPP-së, u vendos afati prej 30 ditësh për parashtrësat me shkrim për ndonjë kundërshtim ndaj provave, ose kërkesë për

hedhjen poshtë të Aktakuzës. Në shqyrtimin fillestar për Aktakuzën, Mbrojtja paraqiti parashtrësat e saj. Më 19 nëntor 2013, Prokurori paraqiti përgjigjen e tij për parashtrësen e Mbrojtjes të datës 18 tetor 2013. Më 16 dhjetor 2013, kryetari i trupit gjykues shqiptoi një Aktvendim, me të cilin e hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes për hedhjen poshtë të Aktakuzës, dhe e dërgoi çështjen për shqyrtim gjyqësor.

4. Me një Urdhër për Caktimin e Seancave të Shqyrtimit Gjyqësor, më datë 20 janar 2014, kryetari i trupit gjykues urdhëroi që shqyrtimi gjyqësor në këtë lëndë të mbahet më 04-05, 25-28 dhe 31 mars dhe 1-4 prill 2014, dhe më vonë e ndryshoi këtë Urdhër me lëshimin më datë 4 shkurt 2014 të një Urdhri për Caktimin e Seancave të Shqyrtimit Gjyqësor më 25 deri në 28 mars 31 mars dhe 01-04 prill dhe 14-17 prill 2014. Më 13 mars 2014 u nxor një Urdhër i ri për Caktimin e Seancave të Shqyrtimit Gjyqësor, në të cilin kryetari i trupit gjykues urdhëroi që shqyrtimi gjyqësor të mbahej në datat 17, 23 dhe 24 prill 2014, në vend të datave 14-17 prill 2014.
5. Në mëngjesin e 25 marsit 2014, dita kur ishte planifikuar të fillonte shqyrtimi gjyqësor, të dy Mbrojtësit të cilët përfaqësojnë të Akuzuarin **Ž. V.**, pra **F. K.** dhe **D. V.**, u arrestuan në lidhje me hetimin në lëndën Ppr. 70/13, për veprën penale të “pengimit të provave ose procedurave zyrtare” në lëndën P. nr. 933/13, në bazë të nenit 394 paragrafi (1) nën-paragrafi (1.7) lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Në të njëjtën ditë, Prokuroria dorëzoi një kërkesë para gjyqtarit të procedurës paraprake në lëndën Ppr. 70/13, ku i kërkonte paraburgimin e të dy Mbrojtësve.
6. Në të njëjtën ditë, kryetari i trupit gjykues mbajti një seancë ku e informoi të Akuzuarin **Ž. V.** lidhur me arrestimin e dy mbrojtësve të tij. Kryetari i trupit gjykues e shtyu fillimin e shqyrtimit gjyqësor, pasi i Akuzuari shprehu vullnetin e tij për t’u përfaqësuar ende nga dy Mbrojtësit e arrestuar më herët atë ditë.
7. Më 28 mars 2014, kryetari i trupit gjykues zhvilloi një seancë në të cilën e informoi të akuzuarin **Ž. V.** se gjyqtari i procedurës paraprake në Lëndën PPR. 70/13 kishte shqiptuar Aktvendim me të cilin i ndalonte të dy Mbrojtësit e tij të kontaktonin të akuzuarin, së bashku me dëshmitarët në Lëndën P. nr. 933/13. Kryetari i trupit gjykues gjithashtu e informoi të Akuzuarin se Aktvendimi ishte apeluar nga dy mbrojtësit. Për shkak se i Akuzuari shprehu vullnetin e tij për t’i mbajtur ata si mbrojtës të tij, kryetari i trupit gjykues e shtyu fillimin e shqyrtimit gjyqësor deri në marrjen e një vendimi nga Gjykata e Apelit në Lëndën PPR. 70/13.
8. Më 31 mars 2014, Gjykata Themelore e Mitrovicës shqiptoi një Aktvendim me të cilin kryetari i trupit gjykues caktoi Mbrojtës sipas detyrës zyrtare me shpenzimet publike, në pajtim me nenin 57 paragrafi (3) të KPP-së, meqë lënda e ngritur kundër të Akuzuarit **Ž. V.** përbën një rast të mbrojtjes së

detyrueshme, të paraparë me nenin 57 paragrafi (1) nën-paragrafi (1.3) të KPP-së. Kohëzgjatja e emërimit të mbrojtësit sipas detyrës zyrtare do të rishqyrtohej nga kryetari trupit gjykues në një fazë të mëvonshme, me t'u shqiptuar vendimi nga Gjykata e Apelit në Lëndën PPR. 70/13.

9. Më 3 prill 2014, Gjykata e Apelit nxori Aktvendim lidhur me ankesën në lëndën PPR. 70/13, me të cilin urdhëroi që të dy mbrojtësit e të akuzuarit të vendoseshin nën arrest shtëpiak, dhe konfirmoi masat ndaluese të caktuara ndaj tyre siç ishte urdhëruar në Aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake në Lëndën PPR. 70/13, më datë 27 mars 2014. Si rezultat i kësaj, më 8 prill 2014, kryetari i trupit gjykues në Lëndën në fjalë shqiptoi Aktvendim me të cilin emëroi sipas detyrës zyrtare Nebojsa Vlajiq si mbrojtës për të akuzuarin **Ž. V.**, në pajtim me nenin 57 paragrafi (3) të KPP-së, meqë Gjykata e Apelit e konfirmoi pjesërisht Aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake në Lëndën PPR. 70/13, i cili ua pamundësoi të dy mbrojtësve, F. K. dhe D. V., të përfaqësonin të Akuzuarin në këtë Lëndë. Më 8 prill 2014, kryetari i trupit gjykues lëshoi një Udhëzim, me të cilin Gjykata e udhëzonte të Pandehurin të angazhonte një Mbrojtës sipas zgjedhjes së tij deri në fund të asaj jave, në pajtim me nenin 11 paragrafët (2) dhe (3), nenin 13 paragrafi (1) nën-paragrafi (1.2) dhe nenin 57 paragrafi (1) nën-paragrafi (1.3) të KPP-së, nëse ai dëshironte kështu, apo që mbrojtësi tashmë i emëruar sipas detyrës zyrtare, domethënë Nebojsa Vlajiq, të mbetej mbrojtës i tij nëse ai nuk angazhohen një tjetër.
10. Me një letër të marrë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë më 10 prill 2014, i Akuzuari **Ž. V.** shprehu vullnetin e tij për të mbajtur Nebojsa Vlajiq si mbrojtës të tij gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë lëndë.
11. Me një Urdhër për caktimin e datës së shqyrtimit gjyqësor më 17 prill 2014, kryetari i trupit gjykues urdhëroi që shqyrtimit gjyqësor të mbahet më 02-04 qershor, 9-11 qershor dhe 18-20 qershor 2014. Një Urdhër i ri për caktimin e seancave të shqyrtimit gjyqësor u lëshua më 29 prill 2014, ku u urdhërua që shqyrtimi gjyqësor në këtë lëndë të fillonte më 06 maj 2014.
12. Seancat e shqyrtimit gjyqësor u mbajtën në publik më 06 maj 2014, 03, 04, 09, 10, 11, 18, 19 qershor 2014 dhe 9 korrik 2014.
13. Gjatë shqyrtimit kryesor më 6 maj 2014, i akuzuari nuk u vetë-deklarua fajtor për akuzën e “Vrasjes së rëndë në tentativë”.
14. Të gjitha seancat e shqyrtimit gjyqësor u mbajtën në praninë e të Akuzuarit **Ž. V.**, i përfaqësuar nga mbrojtësi Nebojsa Vlajiq, dhe Prokurorit të Shtetit, Pascal Persoons. Palët e dëmtuara, \_\_\_\_\_ A. T. dhe \_\_\_\_\_ F. S. morën pjesë në seancën e datës 3 qershor 2014.
15. Më 18 qershor 2014, u zhvillua një vizitë në vendin e ngjarjes, ku dyshohet se ka ndodhur vepra penale.

16. Më 9 korrik 2014, pasi kishte dëgjuar provat në këtë Lëndë, Trupi Gjykes i informoi palët se Gjykata nuk ishte e detyruar sipas kualifikimit juridik të veprës penale, siç ishte parashtruar në Aktakuzën e Prokurorisë, në bazë të nenit 360 paragrafi (2) të KPP-së dhe se Gjykata, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, mund ta ri-klasifikojë veprën origjinale penale në një tjetër, bazuar në fakte që jo tërësisht përkojnë me ato të përshkruara në Aktakuzë, por të cilat nuk konfigurjnë një ndryshim thelbësor të rrethanave.
17. Më 9 korrik 2014, Mbrojtja u informua për këtë mundësi të ri-klasifikimit brenda afatit. Pas kësaj, Trupi Gjykes e informoi Mbrojtjen për të drejtën e saj për të depozituar ndonjë vërejtje dhe për të paraqitur ndonjë provë shtesë lidhur me këtë çështje, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të datës 25 prill 2013.
18. Në të njëjtën ditë, Mbrojtja e informoi Trupin Gjykes se nuk dëshironte të paraqiste ndonjë provë shtesë, por se ajo do të paraqiste vërejtjet lidhur me kualifikimin juridik të veprës penale gjatë deklaratës së saj përfundimtare.
19. Më 9 korrik 2014, Trupi Gjykes dëgjoi fjalët përfundimtare të Prokurorisë dhe Mbrojtjes.
20. Dispozitivi i aktgjykimit u shpall më 10 korrik 2014.
21. Në përputhje me nenin 215 paragrafi (1.1) të KPP-së, përkthyesit ndërkombëtarë ofruan përkthim simultan në të gjitha procedurat gjyqësore dhe të gjitha dokumentet e gjyqësore relevante për shqyrtimin gjyqësor u përkthyen në gjuhën serbe dhe angleze.
22. Në bazë të nenit 541 të KPP-së që hyri në fuqi më 1 janar 2013<sup>1</sup>, shqyrtimi gjyqësor u zhvillua sipas dispozitave të KPP-së së re.

## **1.2. Kompetenca e Gjykatës**

23. Ligji për Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199 (LGJ) gjithashtu ka hyrë plotësisht në fuqi më 1 janar 2013 (neni 43). Ky ligj rregullon juridiksionin territorial dhe lëndor të Gjykatës.
24. Në bazë të nenit 11 paragrafi (1) të Ligjit për gjykatat, gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha lëndët, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.

---

<sup>1</sup> KODI I PROCEDURËS PENALE Nr. 04/L-123;



25. Neni 9 Paragrafi (2) nën-paragrafi (2.7) i po këtij Ligji shpall se Gjykata Themelore e Mitrovicës themelohet për territorin e komunave të Mitrovicës së Jugut dhe Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajt dhe Vushtrrisë. Në bazë të aktakuzës së ngritur, vepra penale e pretenduar ndodhi në Rudare, në autostradën Mitrovicë-Leposaviq, pra brenda juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, nga neni 29 paragrafi (1) i KPP-së. Për më tepër, duke pasur parasysh se kërkesa për fillimin e procedurës u paraqit së pari në atë Gjykatë, në atë kohë Gjykata e Qarkut në Mitrovicë<sup>2</sup>, në pajtim me nenin 29 paragrafi (2) të KPP-së, Gjykata Themelore e Mitrovicës ka juridiksion mbi lëndën.
26. EULEX fitoi kompetencë mbi Lëndën me vendim të Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 30 korrik 2013, dhe në përputhje me Ligjin mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053).<sup>3</sup>
27. Sipas nenit 3 të Ligjit të ri për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 04/L-273, i cili hyri në fuqi më 30 maj 2014 (neni 10), Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në procedurë penale kanë juridiksion dhe kompetencë për lëndët në vazhdim, siç përcaktohet në nenin 1.a të këtij Ligji të ri. Lënda në fjalë iu caktua Gjyqtarëve të EULEX-it para 15 prillit 2014, siç përcaktohet në nenin 1.a paragrafi (2) të Ligjit dhe për këtë arsye Trupi Gjykues i përbërë nga Gjyqtarët e EULEX-it ka juridiksion mbi Lëndën.
28. Lënda u dëgjua nga një Trupi Gjykues i përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Nuno Manuel Ferreira de Madureira, si Kryetar i kolegjit, gjyqtarja e EULEX-it Roxana Comsa dhe Gjyqtari i EULEX-it Iva Nikshiq, si anëtarë të trupit gjykues. Asnjë nga palët nuk e kundërshtoi kompetencën e Gjykatës ose përbërjen e Trupit Gjykues.

### **1.3. Lista e provave të paraqitura**

#### **1. Provat e paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor**

29. Gjatë shqyrtimit gjyqësor u dëgjuan këta dëshmitarë:

<sup>2</sup> Aktvendimi për Fillimin e Hetimit, më datë 20 nëntor 2012, i paraqitur në Shkrimtoren e Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës më 21 nëntor 2012, shih Tabelën 1, Dosja e Gjykatës, PROCEDURA PARAPRAKE, VËLLIMI I;

<sup>3</sup> Vendimi i Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it më datë 30 korrik 2013, ne. 2013.OPEJ.0353-0001, shih Tabelën 7, Dosja e Gjykatës, PROCEDURA PARAPRAKE, VËLLIMI I;

- \_\_\_\_\_ A. T. (i thirrur si i dëmtuar dhe si dëshmitar nga prokurori) u dëgjua më 03 qershor 2014;
  - \_\_\_\_\_ F. S. (i thirrur si i dëmtuar dhe si dëshmitar nga prokurori) u dëgjua më 03 qershor 2014;
  - \_\_\_\_\_ B. S. (Dëshmitar i thirrur nga prokurori) u dëgjua më 04 qershor 2014;
  - \_\_\_\_\_ B. D. (Dëshmitar i thirrur nga prokurori) u dëgjua më 04 qershor 2014;
  - \_\_\_\_\_ A. B. (Dëshmitar i thirrur nga prokurori) u dëgjua më 09 qershor 2014;
  - \_\_\_\_\_ S. G. (Dëshmitar i thirrur nga prokurori) u dëgjua më 09 qershor 2014;
  - \_\_\_\_\_ A. J. (Dëshmitar i thirrur nga prokurori) u dëgjua më 09 qershor 2014;
  - \_\_\_\_\_ D. V. (Dëshmitar i thirrur nga prokurori) u dëgjua më 10 qershor 2014;
  - \_\_\_\_\_ S. V. (Dëshmitar i thirrur nga prokurori dhe Mbrojtja) u dëgjua më 10 qershor 2014;
  - \_\_\_\_\_ E. M. (Dëshmitar i thirrur nga mbrojtja) u dëgjua më 10 qershor 2014;
  - Č. S. (Dëshmitar i thirrur nga mbrojtja) u dëgjua më 11 qershor 2014;
  - D. S. (Dëshmitar i thirrur nga mbrojtja) u dëgjua më 11 qershor 2014.
30. V. V. (Dëshmitar i thirrur nga mbrojtja) u caktua të dëgjohej më 11 qershor 2014. Mbrojtësi i të akuzuarit **Ž. V.** e informoi Trupin Gjykes më 11 qershor 2014 që Dëshmitari do të dëgjohej si dëshmitar ekspert. Prokurori e kundërshtoi dëgjimin e dëshmitarit si dëshmitar ekspert, duke pretenduar se, nëse është kështu, neni 341 paragrafi (1) i KPP-së do të shkelej ngase Ekspertiza e tij nuk ishte e pranueshme pasi që nuk i përmbushte kërkesat e përcaktuara në nenin 138 paragrafi (1) nën-paragrafët (1.2) deri në (1.7) të KPP-së. Më 11 qershor 2014, Trupi Gjykes shqiptoi Aktvendim me gojë duke rënë dakord me vlerësimin e bërë nga Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj lidhur me ankesën e datës 29 nëntor 2013, në të cilin Gjykata e Apelit ra dakord me Prokurorin që ky dokument nuk mund të përdorej në procedurën penale për shkak të papajtueshmërisë së saj me kërkesat e KPP-së<sup>4</sup>. Në bazë të nenit 138 paragrafi (3) të KPP-së, Trupi Gjykes vendosi se Ekspertiza nuk ishte e pranueshme, çka e bëri të pamundur që V. V. të merrej në pyetje si dëshmitar ekspert si pasojë e nenit 341 të KPP-së. Duke e vlerësuar të papranueshme Ekspertizën e V. V.,

<sup>4</sup> Gjykata e Apelit, Aktvendim lidhur me ankesën, më datë 29 nëntor 2013, paragrafi 12, shih Tabelën 3, Dosja e Gjykatës, SHQYRTIMI GJYQËSOR, VËLLIMI I;

Gjykata urdhëroi që Ekspertiza të mbyllej e vulosej dhe të përjashtoj nga shkresat e lëndës gjatë seancës gjyqësore të 11 qershorit 2014<sup>5</sup>.

31. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më datë 19 qershor 2014, u paraqitën si prova një listë dokumentesh nga Dosjet e Prokurorisë<sup>6</sup>, të cilat u vlerësuan të pranueshme:

- Raporti i oficerit të PK-së J. B. më datë 20 gusht 2010;
- Raporti i oficerit të PK-së S. V. më datë 14 gusht 2010;
- Raporti i oficerit të PK-së J. A. më datë 14 gusht 2010;
- Raporti Fillestar i Incidentit më datë 14 gusht 2010;
- Proces-verbal TFM i intervistës së të pandehurit Ž. V. më datë 29 korrik 2013;
- Proces-verbal i intervistës së të pandehurit Ž. V. më datë 23 shtator 2013;
- Proces-verbal i intervistës së dëshmitarit S. G. më datë 04 shtator 2013;
- Proces-verbal i intervistës së dëshmitarit A. T. më datë 04 shtator 2013;
- Proces-verbal i intervistës së dëshmitarit B. S. më datë 04 shtator 2013;
- Proces-verbal i intervistës së dëshmitarit B. D. më datë 04 shtator 2013;
- Proces-verbal i intervistës së dëshmitarit A. B. më datë 04 shtator 2013;
- Proces-verbal i intervistës së dëshmitarit F. S. më datë 04 shtator 2013;
- Proces-verbal i intervistës së dëshmitarit N. D. më datë 05 shtator 2013 me Shtojcën 1 (Dokumentet doganore) dhe Shtojcën 2 (dokumentet policore);
- Proces-verbal i intervistës së dëshmitarit S. M. më datë 05 shtator 2013;
- Proces-verbal i intervistës së dëshmitarit Jovanović Aleksandar më datë 09 shtator 2013;
- Proces-verbal i intervistës së dëshmitarit D. V. 2. më datë 09 shtator 2013;
- Proces-verbal i intervistës së dëshmitarit D. V. më datë 11 shtator 2013;
- Deklarata e dëshmitarit S. V. më datë 05 shtator 2013;
- Deklarata e dëshmitarit S. V. më datë 22 maj 2014;
- Raporti Penal nr. 2010-BI-334 më datë 14 gusht 2010;
- Raporti Policor i Kujdestarisë nga EKIPI 2 më datë 14 tetor 2010;
- Shkresat e BRAVO CONTROL më datë 14 tetor 2010;
- Deklarata e oficerit të policisë S. G. më datë 19 gusht 2010;
- Deklarata e oficerit të policisë B. S. më datë 23 gusht 2010;
- Deklarata e oficerit të policisë F. S. më datë 23 gusht 2010;
- Deklarata e oficerit të policisë B. D. më datë 24 gusht 2010;
- Deklarata e oficerit të policisë A. B. më datë 24 gusht 2010.

---

<sup>5</sup> Shih Ekspertizën me titull “Gjetjet – Ekspertiza e Trafikut - Teknike”, mbyllur në një zarf të vulosur, shih Tabelën 9, Dosja e Gjykatës, SHQYRTIMI GJYQËSOR, VËLLIMI V;

<sup>6</sup> Shih Dosjen e Prokurorisë dhe Dosjen e Policisë;

32. I akuzuari **Ž. V.** dha deklaratë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më datë 19 qershor 2014.

## **2. Kërkesat dhe propozimet**

33. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues mori disa kërkesa dhe propozime lidhur me disa prova dhe nxori vendimet e mëposhtme.

- *Kërkesa për të thirrur dëshmitarë të rinj (ekspertë) – për të mbledhur prova të reja, më datë 24 mars 2014.*

34. Prokuroria kërkoi që të thirren si dëshmitarë (ekspertë) gjatë shqyrtimit kryesor C. B., mjek i mjekësisë ligjore në EULEX, si dhe ekspertët nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike – Departamenti i Trafikut, Prishtinë<sup>7</sup>.

35. Propozimi u refuzua sipas Nenit 258 Paragrafi (2) nën-paragrafi (2.1), dhe Nenit 288 paragrafi (2) të KPP-së, mbi bazën se provat e reja të kërkuara vlerësoheshin të panevojshme ose të tepërta, sepse çështja në fjalë është e njohur<sup>8</sup>.

- *Kërkesa për thirrjen e dëshmitarëve të rinj, më datë 24 mars 2014.*

36. Mbrojtja kërkoi që të thirren në shqyrtim gjyqësor dy dëshmitarë të reja, përkatësisht B. J. dhe K. S.<sup>9</sup>.

37. Propozimi u hodh poshtë në bazë të nenit 288 paragrafi (2) të KPP-së, me arsyetimin se, së pari, Mbrojtja nuk kishte treguar se cilat fakte do të provoheshin nga të dy dëshmitarët të cilët nuk kishin qenë dëshmitarë okularë të ngjarjeve që kishin ndodhur më 14 gusht 2010, dhe, së dyti, të dy dëshmitarë nuk ishin dëshmitarë të rinj sipas përcaktimit në nenin 288 të KPP-së<sup>10</sup>.

- *Kërkesa për mbledhjen e provave të reja ose për thirrjen e dëshmitarëve të rinj, më datë 12 qershor 2014.*

---

<sup>7</sup> Kërkesa për të thirrur dëshmitar të ri (ekspert) – për të mbledhur prova të reja, më datë 24 mars 2014, e depozituar në Shkrimtore më 24 mars 2014, shih Tabelën 10, Dosja e Gjykatës, SHQYRTIMI GJYQËSOR, VËLLIMI II;

<sup>8</sup> Shih Aktvendimin lidhur me Kërkesën e Prokurorisë, më datë 08 maj 2014, shih Tabelën 7, Dosja e Gjykatës, SHQYRTIMI GJYQËSOR, VËLLIMI III;

<sup>9</sup> Shih Kërkesën e Mbrojtjes më datë 24 mars 2014, të depozituar në Shkrimtore më 24 mars 2014, shih Tabelën 12, Dosja e Gjykatës, SHQYRTIMI GJYQËSOR, VËLLIMI II;

<sup>10</sup> Shih Aktvendimin lidhur me Kërkesën e Mbrojtjes, më datë 08 maj 2014, shih Tabelën 8, Dosja e Gjykatës, SHQYRTIMI GJYQËSOR, VËLLIMI III;

38. Mbrojtja kërkoi që të pranohen si prova dy dokumente që i përkisnin Lëndës nr. 2009/BG/168 dhe të merret dokumentacion shtesë në lidhje me kualifikimin ligjor të incidentit që ndodhi në këtë lëndë, që përfshiu një incident trafiku, për të verifikuar nëse prokurori publik e filloi ndjekjen penale në atë lëndë dhe për çfarë akuzash. Propozimi i Mbrojtjes po ashtu kërkonte marrjen në pyetje të një dëshmitari shtesë, B. J., me qëllim që të demonstrohej se kamioni cisternë i përfshirë në faktet e Lëndës në fjalë kishte hyrë në Kosovë në mënyrë të ligjshme<sup>11</sup>.
39. Më 18 qershor 2014, mocioni i Mbrojtjes u refuzua me Aktvendim gojor mbi bazën se provat e kërkuara në Lëndën nr. 2009/BG/168 ishin qartazi të parëndësishme dhe të papranueshme, në bazë të nenit 259 të KPP-së. Nga Gjykata u vendos se provat e kërkuara nuk kishin lidhje me faktet nën hetim në këtë Lëndë dhe thjesht sa e preknin çështjen ligjore për të cilën zbatohet ligji për këtë Lëndë. Trupi Gjykues vendosi më tej me Aktvendim gojor të tij që kërkesa e mbrojtjes për të thirrur B. J. si dëshmitar në këtë Lëndë refuzohej me arsyetimin se provat e nxjerra nga dëshmia e tij ishin të parëndësishme dhe, për këtë arsye, u refuzuan, në bazë të nenit 258 paragrafi (2) nën-paragrafi (2.2) të KPP-së, pasi që çështja nëse kamioni cisternë hyri në Kosovë në mënyrë të ligjshme apo jo, nuk kontestohet dhe këto fakte janë të parëndësishme për vendimin.
- *Kërkesa gojore për prova të reja të deklaratave të dhëna nga dëshmitari S. V., më datë 18 qershor 2014.*
40. Më 18 qershor 2014, Prokuroria i kërkoi Trupit Gjykues të pranohet si provë dy deklaratat e dhëna nga dëshmitari i ish-mbrojtur S. V. më 05 Shtator 2013 dhe më 22 maj 2014. Mbrojtja e kundërshtoi kërkesën duke pretenduar se prova e tillë është e papranueshme në bazë të Nenit 123 paragrafët (2) dhe (3) të KPP-së, dhe duke argumentuar se këto dy deklarata janë marrë në kundërshtim me nenin 131 paragrafi (2) dhe nenin 132 paragrafi (5) të KPP-së.
41. Më 19 qershor 2014, Trupi Gjykues shqiptoi Aktvendim me gojë duke i pranuar si provë të dy deklaratat e mëparshme të dhëna nga Dëshmitari S. V., me arsyetimin se përfshirja e deklaratave të mëparshme të dëshmitarëve në prova është e rregulluar nga nenet 337 dhe 338 të KPP-së, që i lejojnë palët dhe Gjykatën ta ballafaqojnë një dëshmitar nën marrje në pyetje me deklaratat e mëparshme të dhëna, çka ka ndodhur në këtë Lëndë në lidhje me këtë dëshmitar të veçantë. Trupi Gjykues gjeti gjithashtu se të dy deklaratat e mëparshme ishin të pranueshme në bazë të nenit 257 paragrafi (2), megjithëse Dëshmitari ishte dëgjuar në mungesë të Mbrojtjesit. Trupi Gjykues theksoi se Dëshmitari ishte dëgjuar me qëllim të kërkimit të masës mbrojtëse, që iu dha më pas dhe, për rrjedhojë, do të ishte e

---

<sup>11</sup> Shih Kërkesën për të mbledhur prova të reja ose për të thirrur dëshmitarë të rinj, më datë 12 qershor 2014 dhe të depozituar në Shkrimtore më 12 qershor 2014, shih Tabelën 9, Dosja e Gjykatës, SHQYRTIMI GJYQËSOR, Vëllimi IV;

palogjikshme të informohej Mbrojtja në atë kohë. Krahas kësaj, Trupi Gjykes theksoi se Dëshmitari më pas dëshmoi para Gjykatës, gjatë së cilës Mbrojtjes iu dha mundësia për ta ballafaquar dëshmitarin me deklaratat e mëparshme të tij.

## **II. GJETJET FAKTIKE**

### **2.1. Përmbledhje e fakteve të provuara**

42. Gjykata duhej të përcaktonte se cilat janë faktet e provuara në bazë të provave të administruara të paraqitura kundër të Akuzuarit.
42. Pas provave të pranueshme të paraqitura dhe të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata i vlerësoi faktet e mëposhtme relevante si të provuara përtej dyshimit të arsyeshëm:
  - I. Më 14 gusht 2010, Njësia Rajonale për Mbështetjen e Operacioneve (ROSU) në Mitrovicë po zbatonte një plan operativ të quajtur "\_\_\_\_\_ ", që kishte për qëllim ndalimin e kontrabandës së paligjshme të mallrave në veri të Kosovës.
  - II. Në një kohë të caktuar gjatë pasdites së vonë përpara orës 19.00, në rrugën e Rudare mes Zveçanit dhe Mitrovicës, pranë kryqëzimit në Manastirin e Sokolicës, dy policë në veshje të zakonshme arritën të ndalojnë një kamion cisternë që po shkonte në drejtim të Mitrovicës së Jugut, me targë \_\_\_\_\_.
- III. Shoferi i kamionit pranoi se cisterna ishte e ngarkuar me vaj.
- IV. Destinacioni i ngarkesës në kamion ishte Pompa e Benzinës \_\_\_\_\_, pronë e familjes së të akuzuarit, dhe e administruar nga vëllai i tij Z. V. dhe për të cilën i akuzuari punonte në mënyrë të rregullt.
- V. Shoferi i kamionit nuk qe në gjendje të paraqiste të gjitha dokumentet në lidhje me mallin që po transportonte.
- VI. Shoferi i kamionit u urdhërua më pas nga ana e punonjësve të policisë të shkonte me ta në terminalin doganor në Mitrovicën e Jugut.
- VII. Shoferi i kamionit hyri në kamionin e tij, hyri në kabinë, por në vend të ndizte motorin, ai u hodh nga kamioni nga dera e pasagjerit dhe u largua me vrap.
- VIII. Në ndërkohë, një turmë filloi të grumbullohet në rrugën në drejtim të Zveçan, në afërsi të zonës dhe serbë të Kosovës filluan të protestojnë kundër veprimeve të punonjësve të Policisë së shqiptare të Kosovës.

- IX.** Në ndërkohë, në rreth orës 19.00, në vijim të një kërkese për ndihmë, dy ekiye të ndara të uniformuara të Policisë ROSU mbërritën në vendngjarje për të ndihmuar kolegët e tyre.
- X.** Të dëmtuarit, \_\_\_\_\_, A. T. dhe F. S., të veshur me uniforma të policisë dhe me pushkë automatike, u vendosën afër pjesës së pasme të kamionit, për të rregulluar trafikun në vazhdimin e sipër, konkretisht duke ndaluar trafikun që vinte nga Zveçani.
- XI.** Disa minuta pasi shoferi i kamionit ishte larguar me vrap, dhe ndërsa \_\_\_\_\_ A. T. dhe F. S. po qëndronin në mes të rrugës, një motoçikletë me katër rrota që po vinte nga drejtimi i Zveçanit u afrua me dy persona mbi të.
- XII.** Atë e voziste i Akuzuari **Ž. V.**.
- XIII.** Identiteti i udhëtarit mbeti i panjohur.
- XIV.** I Akuzuari u urdhërua nga \_\_\_\_\_ A. T. të ndalonte, duke ngritur dorën e tij mbi kokën e tij me pëllëmbën përpara.
- XV.** Me të kuptuar se shoferi i motoçikletës nuk po ndalur, \_\_\_\_\_ i bëri shenjë shoferit të motoçikletës të ngadalësonte.
- XVI.** I akuzuari, i cili i pa qartë sinjalet dhe i cili ishte plotësisht i vetëdijshëm se duhej të zbatonte urdhrin e \_\_\_\_\_, në vend të kësaj ai voziti me të njëjtën shpejtësi në drejtim të \_\_\_\_\_ A. T. dhe F. S..
- XVII.** \_\_\_\_\_ A. T. dhe F. S. mundën vetëm t'i shmangen përplasjes me automjetin që po vinte përballë duke lëvizur me shpejtësi mënjane. Kështu, motoçikleta arriti kalojë mespërme.
- XVIII.** Pasi vazhdoi vozitjen e tij për disa metra në drejtim të Mitrovicës, i Akuzuari ekzekutoi një kthim U dhe u kthye duke iu afruar kamionit dhe pyeti për veprimet e Policisë në lidhje me kamionin.
- XIX.** Disa çaste më vonë, i Akuzuari u arrestua pranë kabinës kamionit, dhe kështu nuk u lejua të ndërmerre veprime të mëtejshme, ndërsa pasagjeri i motoçikletës arriti t'ia mbathë.
- XX.** I akuzuari veproi me dashje, me qëllimin që të mos lejonte që kamioni së bashku me ngarkesën të vozitej për në terminalin doganor në Mitrovicën e Jugut dhe t'u nënshtrohej procedurave doganore. I akuzuari ishte i vetëdijshëm se kamioni ishte nën ruajtjen e Policisë dhe se personat drejt të

cilëve ai ai e voziti motoçikletën ishin \_\_\_\_\_, të cilët po vepronin në këtë cilësi. I Akuzuari ishte gjithashtu i vetëdijshtë se ngarkesa në kamion ishte e destinuar për Pompën e Gazit \_\_\_\_\_ dhe se kamioni ishte ndaluar nga oficerë shqiptarë të Policisë së Kosovës.

**XXI.** I Akuzuari ishte plotësisht kompetent mendërisht.

## **2.2. Përmbledhje e fakteve të paprovuara**

44. Në rrethanat e përshkruara më sipër, më 14 gusht 2010, rreth orës 19.00, në rrugën midis Zveçanit dhe Mitrovicës, afër kryqëzimit të Manastirit të Sokolicës, i Akuzuari po ngjiste një motoçikletë drejt të dëmtuarve të cilët u përpoqën ta ndalonin atë.

45. Nuk u arrit të vërtetohet se:

**I.** I akuzuari e përdori automjetin e tij qëllimisht si një armë vdekjeprurëse me qëllimin për të vrarë të dëmtuarit;

**II.** I akuzuari pa mundësinë që ai mund t'i godiste ata dhe ata mund të vriteshin nga ky veprim dhe se ai u pajtua me këtë.

## **2.3. Diskutimi dhe analiza e provave**

46. Provat e listuara më sipër (§§29-32) formojnë bazën e vendimit të trupit gjykues në këtë lëndë.

47. Siç u përmend, Trupi Gjykues ka vlerësuar dëshminë e 12 dëshmitarëve, si dhe raportet e policisë dhe prova të tjera materiale të pranuar si prova, për të përcaktuar faktet e pretenduara. Pas marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe të pandehurit, Trupi Gjykues i ka vlerësuar si të besueshme dhe të mbështetshme dëshmitë e dëshmitarëve A. T., F. S., B. S., B. D., A. B., S. G., \_\_\_\_\_ E. M., Ç. S. dhe D. S..

48. Trupi Gjykues ka gjetur se Dëshmitari S. V. nuk është i besueshëm ose i mbështetshëm. Dëshmia e tij e dhënë para Gjykatës, dhe deklaratat e tij të mëparshme të dhëna në Prokurori, e kundërshtojnë fuqishëm njëra-tjetrën<sup>12</sup>. Si rezultat, Trupi Gjykues ka vendosur të mos u japë ndonjë peshë deklaratave dhe dëshmisë së tij në këtë lëndë.

<sup>12</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e S. V., nga faqja 25; Shih proces-verbalin për dëshmitarin S. V. Seanca e Marrjes në Pyetje në Procedurën Paraprake, datë 05 shtator 2013, Shih Tabelën 16, Dosja e Gjykatës, PROCEDURA PARAPRAKE,



49. Është e qartë nga provat në këtë lëndë se më 14 gusht 2010, një operacion i quajtur "\_\_\_\_\_ " ishte duke u zbatuar nga njësia ROSU, me qëllim parandalimin e kontrabandës së mallrave ilegale në veri të Kosovës<sup>13</sup>. Operacioni konsistonte në parandalimin e hyrjes së mallrave në Kosovë pa paguar detyrimet doganore<sup>14</sup> **(FAKTI nr. I)**.
50. Ky operacion u ekzekutua nga oficerë të policisë ROSU të veshur me rroba civile nga Task Force civile<sup>15</sup>. Për ta bërë këtë, ata ishin të autorizuar të ndalonin makina dhe kamionë dhe t'i dërgonin ata në terminalin doganor në Mitrovicën e Jugut, në mënyrë që të paguanin taksat **(FAKTI nr. I)**<sup>16</sup>.
51. Oficeri i policisë i ngarkuar me operacionin "\_\_\_\_\_ " ishte dëshmitari S. G.<sup>17</sup>. Ai ishte edhe udhëheqës i ekipit në atë ditë kritike<sup>18</sup> **(FAKTI nr. I)**.
52. Më 14 gusht 2010, dy oficerët e policisë nga Task Force civile që zbatonte operacionin "\_\_\_\_\_ " ishin Dëshmitari A. B. dhe Dëshmitari B. S.<sup>19</sup>. Të dy ishin të veshur me rroba civile<sup>20</sup> **(FAKTI nr. II)**.
53. Në ditën kritike, provat tregojnë se \_\_\_\_\_, A. B. dhe B. S., arritën të ndalojnë një kamion cisternë në pjesën veriore të Mitrovicës<sup>21</sup>. Kamioni, i cili u ndal në rrugën e Rudare<sup>22</sup>, pranë kryqëzimit në Manastirin e Sokolicës<sup>23</sup>, kishte targën \_\_\_\_\_<sup>24</sup> **(FAKTI nr. II)**.

---

VËLLIMI II; Shih proces-verbalin për dëshmitarin S. V., Seanca e Marrjes në Pyetje, datë 22 maj 2014, Tabela 11, Dosja e Gjykatës, SHQYRTIMI GJYQËSOR, VËLLIMI III;

<sup>13</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 3 deri në faqen 4; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 2; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 14; Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e E. M., faqja 40; Dokument 330 nga Dosja e Prokurorisë;

<sup>14</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 3;

<sup>15</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 2 to faqja 3; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 2; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 15; Dokumenti 330 nga Dosja e Prokurorisë;

<sup>16</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 3 to faqja 4; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 15;

<sup>17</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 14; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 4;

<sup>18</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 23 to faqja 24;

<sup>19</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 4; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 3; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 15;

<sup>20</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 4; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 23; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 5; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 3;

<sup>21</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 3 dhe faqja 6; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 4;

54. Kur kamioni u ndal, shoferi i kamionit u tha \_\_\_\_\_, B. S., A. B. dhe S. G., se cisterna ishte e ngarkuar me vaj<sup>25</sup> **(FAKTI nr. III)**.
55. Dëshmitari B. S. dëshmoi se shoferi i kamionit i tha atij se destinacioni i ngarkesës në kamion ishte Pompa e Gazit \_\_\_\_\_<sup>26</sup>. Dëshmitari B. S. flet serbisht, ndaj kështu arriti të komunikojë me shoferin e kamionit<sup>27</sup>. Kjo është vërtetuar me dëshminë e Dëshmitarit D. V0, i cili deklaroi se karburanti brenda kamionit ishte synuar vërtet për Pompën e Gazit \_\_\_\_\_<sup>28</sup> **(FAKTI nr. IV)**.
56. Dëshmitari B. S. i tregoi Gjykatës se, ndërsa kreu hetime ndaj pompës së gazit \_\_\_\_\_ për një periudhë prej gjashtë muajsh, ai zbuloi se ajo ishte në pronësi të vëllait të të akuzuarit, përkatësisht Z. V.<sup>29</sup>. Kjo u konfirmua nga vetë i Akuzuari<sup>30</sup> dhe u vërtetua nga Dëshmitari D. V.<sup>31</sup> dhe Dëshmitari D. S.<sup>32</sup>. I akuzuari punonte rregullisht në pompën e gazit<sup>33</sup> **(FAKTI nr. IV)**.
57. Si Dëshmitari B. S., ashtu dhe Dëshmitari A. B. dëshmuan se, kur i kërkuan të paraqesë dokumentacionin në lidhje me ngarkesën e kamionit, shoferi i kamionit nuk qe në gjendje të paraqiste ndonjë dokument<sup>34</sup> **(FAKTI nr. V)**. Dëshmitari B. S. dëshmoi se në atë moment shoferi mori

<sup>22</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 16; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 3 to faqja 4;

<sup>23</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 33; Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 2; Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e Č. S., faqja 3; Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 3 to faqja 4 dhe faqja 5;

<sup>24</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 16; Dokumenti 163 nga Dosja e Policisë;

<sup>25</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 3; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 4; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 16;

<sup>26</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 3, faqja 11 dhe faqja 12;

<sup>27</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 3 dhe faqja 8; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 4;

<sup>28</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 11;

<sup>29</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 12;

<sup>30</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 3;

<sup>31</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 7 dhe faqja 12 to faqja 13;

<sup>32</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e D. S., faqja 12;

<sup>33</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e D. S., faqja 12;

<sup>34</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 13; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 4;

telefonin e tij dhe bëri një bisedë me dikë, ku ai kishte deklaruar "Eja këtu sepse më ka ndaluar policia dhe nuk e di se kush janë këta njerëz"<sup>35</sup>.

58. Në atë moment, Dëshmitarët B. S. dhe A. B. thirrën për ndihmë eprorin e tyre, oficerin e policisë S. G.<sup>36</sup>. Dëshmitari S. G. mbërriti në vendngjarje me veturë me kolegun e tij, Dëshmitarin B. D.<sup>37</sup> (**FAKTI nr. IX**).
59. Dëshmitari S. G. kërkoi ndihmë të mëtejshme<sup>38</sup>. Kjo kërkesë u bë me anë të radios rreth orës 19:00<sup>39</sup> (**FAKTI nr. XI**). Pas kësaj kërkesë, të dëmtuarit A. T. dhe F. S. mbërritën në vendngjarje me veturë<sup>40</sup>. Gjithsej dy ekipe të veçanta të punonjësve të \_\_\_\_\_ erdhën në vendin e ngjarjes për të ndihmuar kolegët e tyre B. S. dhe A. B.<sup>41</sup> (**FAKTI nr. XI**).
60. Të gjithë oficerët e \_\_\_\_\_ të cilët mbërritën në vendin e ngjarjes për të ndihmuar kolegët e tyre B. S. dhe A. B. ishin të veshur me uniforma të \_\_\_\_\_<sup>42</sup> (**FAKTI nr. XI**).
61. Në vendngjarje mbërritën edhe oficerët e \_\_\_\_\_ nga stacioni policor i Zveçanit<sup>43</sup>. Dëshmitari D. V. deklaroi se ai ishte thirrur atje nga Dëshmitari A. J.<sup>44</sup> (**FAKTI nr. XI**).
62. Kur mbërriti në vendin e ngjarjes, Dëshmitari S. G. i kërkoi shoferit të kamionit t'i paraqiste atij dokumentet lidhur me kamion dhe ngarkesën e tij.

---

<sup>35</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 3;

<sup>36</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 3; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 4; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 15;

<sup>37</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 16; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 4;

<sup>38</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 4 dhe faqja 5; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 23; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 16;

<sup>39</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 5; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 23;

<sup>40</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 5;

<sup>41</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 3;

<sup>42</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 5; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 23; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 6; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 16 dhe faqja 25; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 4; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 15; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 37;

<sup>43</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 32 to faqja 33;

<sup>44</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 2;

Ai dëshmoi se shoferi i tha se ai nuk kishte asnjë dokument<sup>45</sup>. I dëmtuari F. S. e konfirmoi këtë fakt në shqyrtimin gjyqësor<sup>46</sup> (**FAKTI nr. V**).

63. Meqenëse shoferi i kamionit nuk paraqiti asnjë dokument në lidhje me ngarkesën e kamionit, Dëshmitari S. G. urdhëroi që kamioni të sillej në terminalin doganor që gjendet në Mitrovicën Jugore<sup>47</sup> (**FAKTI nr. VI**). Dëshmitari B. S. konfirmoi se Dëshmitari S. G. e udhëzoi atë ta urdhëronte shoferin e kamionit t'i ndiqte ata për në terminalin doganor<sup>48</sup>. Kur ai veprroi kështu, shoferi i kamionit u përgjigj: "*jo doganë*"<sup>49</sup> (**FAKTI nr. VI**).
64. I dëmtuari A. T., i cili mbërriti në vendngjarje pas Dëshmitarit S. G., konfirmoi se Dëshmitari S. G. u kishte thënë atyre se shoferi i kamionit ishte urdhëruar nga \_\_\_\_\_ t'i ndiqte ata për në terminalin doganor<sup>50</sup> (**FAKTI nr. VI**).
65. Provat në këtë lëndë tregojnë se, kur u urdhërua që të shkojnë në terminalin doganor, shoferi i kamionit hyri brenda në kamion. Në vend që të ndizte motorin e kamionit, shoferi u arratis nëpër derën e pasagjerit. Kjo u konfirmua nga dëshmitë e Dëshmitarit B. D., Dëshmitarit A. B. dhe Dëshmitarit S. G.<sup>51</sup> (**FAKTI nr. VII**). Dëshmitari S. G. u tha të Dëmtuarve A. T. dhe F. S. në vendin e ngjarjes se shoferi kishte ikur<sup>52</sup> (**FAKTI nr. VII**).
66. Dëshmitari S. G. informoi eprorin e tij \_\_\_\_\_ E. M. lidhur me ikjen e shoferit<sup>53</sup>.
67. Në ndërkohë, një turmë prej civilësh ishin mbledhur në afërsi të vendit të ngjarjes<sup>54</sup>. Provat tregojnë se turma ishte armiqësore ndaj \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_

---

<sup>45</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 16;

<sup>46</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 24;

<sup>47</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 16; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 17; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 5;

<sup>48</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 13;

<sup>49</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 13;

<sup>50</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 6;

<sup>51</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 17; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 5; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 16; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 7;

<sup>52</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 6 dhe faqja 10; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 23;

<sup>53</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 16;

<sup>54</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 5; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 12; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 16; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 33; Shih proces-verbalin e seancës së datës

të pranishëm në vendin e ngjarjes<sup>55</sup>. Kjo u konfirmua nga Dëshmitari Ç. S., përfaqësues i fshatit \_\_\_\_\_, i cili dëshmoi se njerëzit nga Zveçani nuk donin ta shihnin këtë njësi \_\_\_\_\_ të ndërhynte "në rajonin e tyre"<sup>56</sup>. Provat në këtë lëndë tregojnë se atje u mbledhën rreth 25 deri në 30 njerëz<sup>57</sup> (**FAKTI nr. VIII**).

68. Ç. S., si përfaqësues i fshatit, iu afrua oficerëve të \_\_\_\_\_<sup>58</sup>. Është vërtetuar nga provat se Dëshmitari S. G. komunikoi drejtpërdrejt me të dhe i shpjegoi atij operacionin e tyre dhe arsyet e pranisë së tyre, domethënë, se një kamion i ngarkuar me mall nuk kishte paguar tarifën doganore<sup>59</sup>. Dëshmitari S. G. ishte shumë bashkëpunuese me përfaqësuesin e fshatit<sup>60</sup>; ky përshkrim i sinqertë nga një dëshmitar i cili, nisur nga rrethanat, pritej të ishte mosbesues ndaj asaj që përfaqësonte Dëshmitari S. G., ia shtoi besueshmërinë deklaratës së tij (**FAKTI nr. VIII**).
69. Të dëmtuarit A. T. dhe F. S., të cilët ishin të dy në uniforma të \_\_\_\_\_<sup>61</sup>, u vendosën afër pjesës së pasme të kamionit,<sup>62</sup> për të rregulluar trafikun në vazhdim që vinte nga Zveçani, që në atë kohë nuk ishte i ngarkuar<sup>63</sup>. Për këtë, të dëmtuarit A. T. dhe F. S u vendosën në mes të rrugës<sup>64</sup> (**FAKTI nr. X**).
70. Në një moment të caktuar, mbërriti një motoçikletë me katër , me dy persona mbi të<sup>65</sup> (**FAKTI nr. XI**).
71. Shoferi i motoçikletë, i cili erdhi nga drejtimi i Zveçanit<sup>66</sup>, po voziste në drejtim të të dëmtuarve A. T. dhe F. S.<sup>67</sup> (**FAKTI nr. XI**).

---

11 qershor 2014, Dëshminë e Ç. S., faqja 3; Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e D. S., faqja 10;

<sup>55</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 7 dhe faqja 16; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 25;

<sup>56</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e Ç. S., faqja 4;

<sup>57</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 30; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 12;

<sup>58</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 17; Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e Ç. S., faqja 3;

<sup>59</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 17; Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e Ç. S., faqja 4;

<sup>60</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e Ç. S., faqja 8;

<sup>61</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 5 dhe 14-15; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 23 dhe faqja 32 to faqja 33;

<sup>62</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 17; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 9;

<sup>63</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 5 to faqja 6 dhe faqja 20; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 25 dhe faqja 30; Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e D. S., faqja 10;

<sup>64</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 14; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 25;

<sup>65</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 26;

72. Disa dëshmitarë në këtë lëndë dëshmuan se shoferi i motoçikletës iu afrua atyre me shpejtësi të madhe<sup>68</sup> (**FAKTI nr. XI**). Shpejtësia faktike e nuk u arrit të vërtetohet për shkak të mungesës së elementeve objektive si tabelat shenjuese, por Gjykata pranon se oficerët e policisë janë të aftë të vlerësojnë nëse shpejtësia e një automjeti është e përshtatshme për një terren të caktuar.
73. Shoferi i motoçikletës është identifikuar si i akuzuari **Ž. V.**<sup>69</sup> (**FAKTI nr. XII**). Vetë i Akuzuari dëshmoi se po e ngiste motoçikletën me shpejtësi të madhe, me jo më pak se 60 km/orë<sup>70</sup> (**FAKTI nr. XI**).
74. Bashkë me shoferin në motoçikletë ishte dhe një pasagjer<sup>71</sup>. Megjithatë nuk ka prova në këtë lëndë për të vërtetuar identitetin e tij (**FAKTI nr. XIII**).
75. Ndërsa shoferi i motoçikletës po voziste në drejtim të dy të dëmtuarve, i dëmtuari A. T. ngriti dorën e tij për t'i treguar shoferit të ngadalësonte dhe të ndalonte<sup>72</sup> (**FAKTI nr. XIV**). Ky fakt u konfirmua nga i Akuzuari gjatë dëshmisë së tij para Gjykatës<sup>73</sup>. Për këtë, A. T. ngriti dorën e tij mbi kokën e tij dhe pastaj përdori shenjën e ngadalësimit<sup>74</sup>, një gjest universal i njohur me lehtësi nga çdo shofer (**FAKTI nr. XIV**). Këtë fakt e konfirmuan edhe oficerët e policisë së stacionit policor në Zveçan, të cilët erdhën për të dëshmuar si dëshmitarë<sup>75</sup> (**FAKTI nr. XIV**).

<sup>66</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 7 to faqja 8; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 25; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 5;

<sup>67</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 8;

<sup>68</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 8; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 26; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 19; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 5; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 17 dhe faqja 27; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 34;

<sup>69</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 10; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 28; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 28; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, A. J., faqja 32 dhe faqja 34;

<sup>70</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 4 dhe faqja 5: “*I can't say exactly what the speed was 60 km/h – 70 km/h or maybe 80 km/h*”;

<sup>71</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 9;

<sup>72</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 8; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 26; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 5 dhe faqja 9 to faqja 10;

<sup>73</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 4 “*As I was passing by, I could see a man waving his hands in a sign to slow down*”;

<sup>74</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 8; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 26; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 19; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 5;

<sup>75</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, A. J., faqja 32;

76. Duke kuptuar se shoferi i motoçikletës nuk po ndalonte, i dëmtuari A. T. ia bëri një shenjë shoferit të ngadalësonte. Për këtë, A. T. uli dorën që të tregonte shpejtësinë<sup>76</sup>. I akuzuari e konfirmoi këtë fakt gjatë dëshmisë së tij<sup>77</sup> (**FAKTI nr. XV**).
77. I Akuzuari dëshmoi se, sapo e kuptoi se në rrugën e tij ishte një oficer i policisë, menjëherë ai filloi ta ngadalësojë shpejtësinë<sup>78</sup>. Megjithatë kjo nuk është vërtetuar nga një shumicë e madhe e dëshmitarëve të cilët erdhën për të dëshmuar para kësaj Gjykate. Nga dëshmitë e tyre rezulton se shoferi i motoçikletë nuk e zbatoi urdhrin e oficerit të policisë, sepse ai nuk ndaloi motocikletën, as e ngadalësoi shpejtësinë<sup>79</sup>. Dëshmitari S. G. dëshmoi se në të vërtetë shoferi i motoçikletës e rriti shpejtësinë<sup>80</sup>. Përkundrazi, Dëshmitari A. J. deklaroi se motoçikleta e ngadalësoi shpejtësinë sapo që iu dha sinjali nga A. T. për ta bërë këtë<sup>81</sup>. Trupi Gjykues nuk i vlerëson të sakta këto dy përshkrime. Dëshmitë në këtë lëndë tregojnë se shoferi voziti në të njëjtën shpejtësi<sup>82</sup> (**FAKTI nr. XVI**). Dëshmitari D. V. deklaroi se ai u informua nga punonjësit e policisë në stacionin policor në Zveçan se shoferi nuk ndaloi, apo nuk ishte në gjendje të ndalonte<sup>83</sup>, çka forcon më tej versionin e kolegëve të tij të përfshirë në operacionin " \_\_\_\_\_ " (**FAKTI nr. XVI**).
78. Shoferi i motoçikletë e vazhdoi vozitjen në drejtim të të dëmtuarit A. T.<sup>84</sup> dhe "*kaloi pranë policisë*" siç u deklarua nga vetë i akuzuari<sup>85</sup> (**FAKTI nr. XVII**).
79. Për shkak se shoferi i motoçikletës nuk ndaloi, as e ngadalësoi vozitjen, oficerët e policisë A. T. dhe F. S. u detyruan të lëvizin instinktivisht mënjanë, për të dalë nga rruga e saj<sup>86</sup> (**FAKTI nr. XVII**). Provat tregojnë se të

<sup>76</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 8; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 26; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 3 to faqja 4;

<sup>77</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 5 dhe faqja 8;

<sup>78</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 4;

<sup>79</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 8; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 26 to faqja 27; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 4; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 19;

<sup>80</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 17;

<sup>81</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, A. J., faqja 32;

<sup>82</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 35 to faqja 36; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 24;

<sup>83</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 7;

<sup>84</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 8 to faqja 9; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 3;

<sup>85</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 4 dhe faqja 8;

<sup>86</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 8 dhe faqja 9; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 26 to faqja 27, faqja 36 to faqja 37; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S.,

dëmtuarit A. T. dhe F. S. u detyruan të largohen mënjane shpejt, për të shmangur përplasjen me motoçikletën, megjithëse nuk iu nevojiti të ekzekutonin ndonjë akrobaci ekstreme apo të hidheshin mënjane në tokë<sup>87</sup> (**FAKTI nr. XVII**).

80. Provat në këtë lëndë tregojnë se, pasi kaloi përmes dy oficerëve të policisë, shoferi i motoçikletës vazhdoi të voziste për disa metra në drejtim të Mitrovicës dhe pastaj ekzekutoi një kthesë U<sup>88</sup>. Kjo u konfirmua nga i akuzuari gjatë dëshmisë së tij, kur ai deklaroi se, pasi kaloi përmes oficerëve të policisë, ai më pas "u kthye përsëri"<sup>89</sup> (**FAKTI nr. XVIII**). Dëshmitari Ç. S. dëshmoi se kur mbërriti në vendngjarje, ai pa motoçikletën të parkuar pranë kabinës së kamionit<sup>90</sup>. Dëshmitari D. S. dëshmoi se motoçikleta ishte parkuar diku në afërsi të kamionit rreth pjesës së pasme, ose në mes të kamionit<sup>91</sup> (**FAKTI nr. XVIII**).
81. Më tej, provat tregojnë se, pasi e ndaloi automjetin e tij, shoferi i motoçikletës i shkoi shumë afër kamionit<sup>92</sup> ku po qëndronte dëshmitari B. D.<sup>93</sup>. Ky fakt është konfirmuar nga i Akuzuari, i cili dëshmoi se, pasi kaloi pranë policëve, ai u kthye prapa në vendin ku po qëndronin oficerët e policisë, dhe e parkoi motoçikletën e tij pranë kamionit<sup>94</sup>. Më pas i Akuzuari deklaroi se ai erdhi përballë një grupi oficerësh të policisë, të cilët po qëndronin atje<sup>95</sup>. Përveç kësaj, dëshmitari B. D. dëshmoi se shoferi i motoçikletës donte të ecte në drejtim të kamionit, por ai arriti ta kapte atë para se të arrinte kamionin<sup>96</sup>. I dëmtuari A. T. konfirmoi se shoferi i motoçikletës iu afrua shumë derës së kamionit<sup>97</sup> (**FAKTI nr. XVIII**).

---

faqja 4; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 19; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 6;

<sup>87</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 9 dhe faqja 18, faqja 20; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 19 to faqja 20; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 6 dhe faqja 10; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 17;

<sup>88</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 9; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 27; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 20; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 6 and faqja 11; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 18 dhe faqja 24; Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 7;

<sup>89</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 4;

<sup>90</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e Ç. S., faqja 4 to faqja 5;

<sup>91</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e D. S., faqja 10;

<sup>92</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 26; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 4;

<sup>93</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 9;

<sup>94</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 4;

<sup>95</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 14;

<sup>96</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 20;

<sup>97</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 10;



82. Dëshmitari A. J. deklaroi se shoferi i motoçikletës kërkoi të kuptonte pse ishte ndalur kamioni dhe çfarë problemi kishte<sup>98</sup>. Dëshmia e dëshmitarit D. V. e vërteton këtë fakt<sup>99</sup>. I akuzuari dëshmoi se ai i pyeti oficerët e policisë se çfarë po ndodhte, por mohoi të kishte pyetur në lidhje me kamionin<sup>100</sup>. Gjykata nuk e vlerësoi të sinqertë këtë pohim duke marrë parasysh deklaratat e besueshme në të kundërtën të oficerëve të përmendur të oficerëve serbë të Policisë së Kosovës, të cilët në disa raste dukeshin disi të interesuar që të mbulonin veprimet e të akuzuarit (**FAKTI nr. XVIII**).
83. Ndërsa i Akuzuari ndaloj, pasagjeri i motoçikletës u largua dhe u arratis në turmën e njerëzve të mbledhur në afërsi të vendngjarjes<sup>101</sup> (**FAKTI nr. XIX**).
84. Pastaj oficerët e Policisë ROSU arrestuan shoferin e motoçikletës<sup>102</sup> (**FAKTI nr. XIX**).
85. Shumë dëshmitarë dëshmuan se arrestimi i të akuzuarit u krye sipas procedurës normale<sup>103</sup> (**FAKTI nr. XIX**).
86. Gjykata nuk e ka gjetur të besueshme deklaratën e të Akuzuarit dhe të Dëshmitarit A. J. të cilët deklaruan se i akuzuari ishte keqtrajtuar gjatë arrestimit të tij të pajustificuar dhe arbitrar<sup>104</sup>. Gjykata është në dijeni të rrethanave unike që karakterizojnë pjesën veriore të Kosovës, sidomos në vitin 2010, dhe e gjen të pakonceptueshme që Oficerët e shqiptarë të Policisë së Kosovës të përdornin rrugën e dhunës së panevojshme ndaj një serbi të Kosovës në pjesën veriore të Mitrovicës, para një turme të përbërë nga serbë të Kosovës dhe nga oficerë serbë të Policisë së Kosovës nga stacioni Policor i Zveçanit. Dëshmitari A. J. nuk shpjegoi gjithashtu se

<sup>98</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, A. J., faqja 32 dhe faqja 43;

<sup>99</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 7;

<sup>100</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 12;

<sup>101</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 9 and faqja 21; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 26; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 20; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 18;

<sup>102</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 9 dhe faqja 10; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 26; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 4; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 20; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 6; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 18; Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e Č. S., faqja 4; Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 7;

<sup>103</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 10; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 28;

<sup>104</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, A. J., faqja 32, faqja 38 dhe faqja 43; Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 4;

përse ai nuk reagoi përballë një dhune të tillë kinse të kryer nga oficerët shqiptarë të Policisë së Kosovës<sup>105</sup> (**FAKTI nr. XIX**).

87. Krahas kësaj, Dëshmitari A. J. deklaroi gjithashtu se gjatë arrestimit të të akuzuarit, dëshmitari S. G. kishte shtyrë me pëllëmbë një oficer të Policisë së Zveçanit<sup>106</sup>. Megjithatë asnjë dëshmitar tjetër i cili u paraqit për të dëshmuar para kësaj Gjykate, nuk raportoi për një sjellje të tillë të papërshtatshme. Në fakt, dëshmitari D. V. dëshmoi se rreshteri udhëheqës i ekipit nga Njësia ROSU u soll normalisht ndaj oficerëve të policisë të stacionit policor të Zveçanit<sup>107</sup>. Përveç kësaj, siç u përmend më lart (shih §68), dëshmitari S. G. u përshkrua nga një përfaqësues serb i Kosovës si bashkëpunues në rrethana të tilla shumë të vështira, sjellje që nuk përputhet me atë të një udhëheqësi ekipi që do të abuzonte me pushtetin e tij (**Fakti nr. XIX**).
88. Arrestimi, përfundoi Gjykata, ishte pasojë e natyrshme e veprimeve të momenteve të mëparshme të të akuzuarit, dhe jo siç u përpoq ta portretizonte i akuzuari, një sjellje prepotente apo autoritare nga ana e oficerëve shqiptarë të Policisë së Kosovës.
89. Dëshmitari A. J. deklaroi se në momentin e arrestimit të të akuzuarit, dëshmitari S. V. e informoi bazën e tyre me anë të radio-kontrollit Bravo. Dëshmitari A. J. i telefonoi gjithashtu Komandantit të Stacionit të Policisë, për ta informuar për situatën. Ai gjithashtu deklaroi se informoi zëvendës komandantin e operacioneve<sup>108</sup>. Dëshmitari D. V. konfirmoi se dëshmitari A. J. kontaktoi me të, pasi ai ishte Shef i Operacioneve në Stacionin Policor të Zveçanit<sup>109</sup>.
90. Trupi Gjykues gjen se i akuzuari, si shofer i motoçikletës, veprroi me dashje me qëllim që të mos lejonte që kamioni bashkë me ngarkesën e tij të drejtohej për në terminalin doganor në Mitrovicën e Jugut, dhe t'u nënshtrohej procedurave doganore (**FAKTI nr. XX**).
91. Ka prova të forta që e lidhin të Akuzuarin me kamionin dhe ngarkesën e tij. Edhe pse i Akuzuari dëshmoi se ai nuk kishte asnjë lidhje me kamionin<sup>110</sup>, provat në këtë çështje tregojnë të kundërtën (**FAKTI nr. XX**).

---

<sup>105</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, A. J., faqja 43;

<sup>106</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, A. J., faqja 32 dhe faqja 38;

<sup>107</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 6;

<sup>108</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, A. J., faqja 32 to faqja 33;

<sup>109</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 2;

<sup>110</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 11;

92. Siç u përmend më lart, provat tregojnë se ngarkesa e kamionit ishte synuar për pompën e gazit \_\_\_\_\_, një pompë gazi në pronësi të familjes së të Akuzuarit dhe ku i akuzuari punonte rregullisht (**FAKTI nr. XX**).
93. Për më tepër, provat përcaktojnë në mënyrë të qartë se pasi i Akuzuari kaloi përmes dy oficerëve të policisë ROSU, ai ekzekutoi një kthesë U. Trupi Gjykues beson se kjo nuk ishte rastësi dhe se i akuzuari, me qëllim, kërkoi të kuptonte se çfarë problemi kishte me kamionin. Kjo vërtetohet nga shumë dëshmitarë të cilët dëshmuuan se, pasi i akuzuari ndali motoçikletën e tij, ai u përpoq të shkonte shumë afër derës së kamionit<sup>111</sup>. A. T. dëshmoi se kishte përshtypjen se i akuzuari kishte për qëllim të hynte në kamion dhe ta largonte atë nga mbikëqyrja e Policisë<sup>112</sup>. Ai madje deklaroi: *"incidenti ndodhi për shkak të atij kamioni"*<sup>113</sup>. Për më tepër, dëshmitari B. S0 deklaroi se ata *"e dinin se dikush po vinte për të na larguar neve dhe për të marrë kamionin"*<sup>114</sup>. Kjo rezulton nga fakti se, pasi shoferi i kamionit u ndal nga oficerët e Policisë ROSU, ai telefonoi dikë dhe i kërkoi atij personi që të vinte (**FAKTI nr. XX**).
94. Përveç kësaj, ka prova të forta që tregojnë se i Akuzuari u interesua dhe pyeti në lidhje me kamionin. Ky interesim tregon një lidhje të qartë mes të Akuzuarit dhe automjetit. Sipas Dëshmitarit S. G., pasi i Akuzuari ndaloi motoçikletën e tij, ai pyeti në lidhje me kamionin<sup>115</sup>. Kjo është vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve A. J.<sup>116</sup> dhe D. V.<sup>117</sup>. Dëshmitari A. J. gjithashtu dëshmoi se ai e kuptoi nga pyetjet e të Akuzuarit në lidhje me kamionin se ngarkesa e kamionit i përkiste të Akuzuarit<sup>118</sup>. A. J. më tej tha se pasi mori të Akuzuarin nga stacioni i policisë në jug të Mitrovicës, e pyeti atë *"nëse mallrat në kamion kishin dokumente të rregullta"*. I akuzuari i ishte përgjigjur se *"ai kishte në posedim dokumentacion të rregullt"*, dhe u tha oficerëve të policisë së Zveçanit se kamioni e kishte kaluar doganën pa asnjë problem<sup>119</sup> (**FAKTI nr. XX**).
95. Nën dritën e provave në këtë lëndë, Trupi Gjykues nuk e beson versionin e fakteve të paraqitura nga i Akuzuari se ai po voziste në këtë rrugë në mënyrë që të merrte pjesë në mbledhjen e shoferëve të motoçikletave<sup>120</sup>, version i fakteve i paraqitur për herë të parë gjatë procedurës (**FAKTI nr. XX**).

<sup>111</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 9; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e F. S., faqja 26 and faqja 31;

<sup>112</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 9;

<sup>113</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 18;

<sup>114</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 4;

<sup>115</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 18 and faqja 23;

<sup>116</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 32 and faqja 43;

<sup>117</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 7 to faqja 8;

<sup>118</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 43;

<sup>119</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 44;

<sup>120</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 11;

96. Trupi Gjykues gjen se i Akuzuari ishte në dijeni se kamioni ishte nën mbikëqyrjen e Policisë dhe se personat drejt të cilëve ai voziti ishin oficerë të policisë të cilët vepronin me këtë cilësi (**FAKTI nr. XX**).
97. Siç u përmend më herët, kur u ndal nga oficerët e Policisë ROSU, shoferi i kamionit telefonoi dikë dhe i kërkoi atij personi të vinte. Edhe pse nuk ka prova se personi që ai telefonoi ishte vetë i Akuzuari, ka shumë mundësi të ketë qenë i Akuzuari, apo dikush tjetër i cili kontaktoi menjëherë me të Akuzuarin. Në fakt, nuk kaloi shumë kohë dhe i Akuzuari u shfaq në vendngjarje pasi ishte bërë telefonata dhe i akuzuari u interesua për kamionin sapo arriti dhe menjëherë para se ta arrestonin.
98. Për më tepër, provat kanë vërtetuar se i Akuzuari mbërriti në vendin e ngjarjes me shpejtësi të madhe, pa marrë parasysh faktin se trafiku ishte i ngarkuar me një varg automjete të parkuara në anë të rrugës dhe se ishte mbledhur një turmë<sup>121</sup>. Kjo tregon se i Akuzuarit kishte për qëllim të shkonte në vendin e ngjarjes dhe donte ta bënte këtë me urgjencën më të madhe (**FAKTI nr. XX**).
99. Për më tepër, Trupi Gjykues gjen se i akuzuari nuk mundi të provojë faktin se ai nuk e kishte parë që vendi i ngjarjes ishte nën kontrollin e policisë. Ka prova të qarta që tregojnë se disa oficerë policie ishin të pranishëm në vendin e ngjarjes. Të gjithë, me përjashtim të dy oficerëve të policisë, kishin veshur uniforma të policisë. Provat vërtetojnë edhe se i dëmtuari A. T., si personi i parë drejt të cilit voziti i akuzuari, kishte veshur uniformë policie. Për më tepër, i dëmtuari A. T. mbante një armë të gjatë, AK47<sup>122</sup>. Krahas kësaj, rreth kamionit ishin parkuar disa makina policie<sup>123</sup>. Kjo u konfirmua nga vetë i Akuzuari, i cili dëshmoi se në vendin e ngjarjes kishte automjete policie<sup>124</sup>. Si rezultat, Trupi Gjykues nuk e beson të Akuzuarin, veçanërisht pasi ai u ballafaqua me deklaratat kontradiktore të mëparshme të tij<sup>125</sup>, kur ai dëshmon para Gjykatës se e kuptoi se personi që i bëri shenjë për të ngadalësuar ishte oficer \_\_\_\_\_ vetëm pasi e kishte kaluar atë<sup>126</sup> (**FAKTI nr. XX**).

---

<sup>121</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 10;

<sup>122</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 14; Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. S., faqja 6; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 37; Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 8;

<sup>123</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 04 qershor 2014, Dëshminë e B. D., faqja 18; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 8; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, A. J., faqja 32; Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e D. S., faqja 11; Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 7; Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e Č. S., faqja 4;

<sup>124</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 8 to faqja 9;

<sup>125</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 7;

<sup>126</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 6;

100. Provat tregojnë gjithashtu se hapësira e lirë që kishte mbetur në rrugën ku po voziste i akuzuari ishte shumë e ngushtë. Dëshmitari A. B. deklaroi se përveç se atje, i Akuzuari nuk kishte asnjë rrugë tjetër ku mund të voziste<sup>127</sup>. Dëshmitari A. J. dëshmoi se në rrugën midis kamionit dhe automjeteve të ROSU-t të parkuara në anë kishte një hapësirë të lirë me gjerësi nga 2 deri në 3 metra<sup>128</sup>. Provat tregojnë se kamioni ishte ndalur pjesërisht në rrugë dhe pjesërisht në anë të rrugës<sup>129</sup>. Përveç kësaj, Dëshmitari A. J. dhe Dëshmitari D. V. deklaruan se nuk ishte e mundur të kalohej përmes trafikut për shkak të hapësirës së vogël të mbetur në rrugë<sup>130</sup> (**FAKTI nr. XVII**).
101. Nën dritën e provave në këtë lëndë, Trupi Gjykues gjeti se i akuzuari ishte gjithashtu i vetëdijshëm se ngarkesa e kamionit ishte e destinuar për pompën e Gazit \_\_\_\_\_ dhe se kamioni ishte ndalur nga oficerë shqiptarë të Policisë së Kosovës (**FAKTI nr. XX**).
102. Kjo konfirmohet nga provat që e lidhin të Akuzuarin me kamionin, siç u vlerësua më lart (**FAKTI nr. XX**).
103. Krahas kësaj, provat tregojnë se ka pasur një armiqësi të qartë ndaj oficerëve shqiptarë të Policisë së Kosovës të cilët u përpoqën të vinin në zbatim operacionin "\_\_\_\_\_". Dëshmitari Ç. S., përfaqësues i fshatit \_\_\_\_\_, dëshmoi se njerëzit nga Zveçani "*nuk dëshironin që ndonjë nga këto njësi të ndërhynte në rajonin [e tyre]*"<sup>131</sup> dhe se "*njerëzit tanë nuk lejojnë asnjë arrestim*"<sup>132</sup>. Ai gjithashtu shpjegoi politikën e vetë-administrimit lokal të rajonit<sup>133</sup>. Këto janë arsyet se pse në afërsi të incidentit u mblodh një turmë e përbërë nga serbë të Kosovës.
104. Ka gjithashtu prova që tregojnë çështjen e oficerëve shqiptarë të Policisë së Kosovës që vinin në zbatim operacionin policor në veri të Kosovës. Në ditën kritike, dëshmitari Ç. S. u tregoi oficerëve të policisë ROSU se njësitë e tyre nuk duhej të ndërhynin në këtë rajon dhe se ata mund të vërenin se si reagonin njerëzit ndaj pranisë së tyre, gjë e cila mund të shkaktonte probleme të mëdha<sup>134</sup>. Ai dëshmoi më tej se në takimin e kuvendit

<sup>127</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 11;

<sup>128</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 33 and faqja 40;

<sup>129</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e Ç. S., faqja 3; Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e D. S., faqja 10; Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 4;

<sup>130</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 33; Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 6;

<sup>131</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e Ç. S., faqja 4;

<sup>132</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e Ç. S., faqja 3;

<sup>133</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e Ç. S., faqja 4;

<sup>134</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e Ç. S., faqja 4

administrata lokale kishte marrë një vendim që "të mos lejohet asnjë polic tjetër të punojë në territorin tonë", përveç policisë së tyre lokale<sup>135</sup>.

105. Po kështu, është vërtetuar me prova se në vendin e ngjarjes pati një keqkuptim lidhur me çështjen se kush e kishte përgjegjësinë për të vepruar<sup>136</sup>. Në fund hetimin në lidhje me kamionin dhe shoferin e motoçikletës e morën përsipër oficerët e policisë të Stacionit Policor në Zveçan<sup>137</sup>. Dëshmitari A. J. e informoi Gjykatën se rastin e mori përsipër S. M.<sup>138</sup>. Është vërtetuar se \_\_\_\_\_ E. M. vendosi që rasti duhej të merrej nga Stacioni Policor i Zveçanit<sup>139</sup>.
106. Ka gjithashtu prova që tregojnë se oficerët e policisë së Zveçanit nuk kontaktuan me zinxhirin e duhur komandues në ditën kritike. Atë ditë D. V. 2., i cili ishte zëvendës i N. G., ishte duke vepruar në cilësinë e komandantit<sup>140</sup>. Megjithatë provat tregojnë se atë ditë atë nuk e kontaktuan, as e informuan për rastin<sup>141</sup>. Në vend të kësaj, dëshmitari D. V. thirri Komandantin e Stacionit Policor N. G. megjithëse ky i fundit ishte me leje atë ditë<sup>142</sup>. Ai konfirmoi se Komandanti në detyrë atë ditë ishte D. V. 2.<sup>143</sup>. Siç u tha nga dëshmitari E. M. gjatë shqyrtimit gjyqësor, procedura e duhur do të kishte qenë kontaktimi i Komandantit në detyrë<sup>144</sup>.
107. Nga e gjithë kjo rezultoi që i Akuzuari si përfundim u mor nga stacioni i policisë në Mitrovicën e Jugut dhe u dërgua nga oficerët serbë të Policisë së Kosovës në Stacionin Policor të Zveçanit, nga ku më pas u lirua<sup>145</sup>.
108. Ka prova që tregojnë se ngarkesa e kamionit ishte e dyshimtë, duke filluar që nga arratisja e shoferit. Përveç kësaj, Dokumenti 360 në dosjen e Prokurorisë, që u verifikua dhe vërtetua nga dëshmitari D. V.<sup>146</sup>, thekson se kamioni ishte i ngarkuar me "hollues" në sasinë "23.340 kg"<sup>147</sup>. Dëshmitari

---

<sup>135</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e Č. S., faqja 6 to faqja 7;

<sup>136</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 11;

<sup>137</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 11 dhe faqja 16;

<sup>138</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 35 dhe faqja 36;

<sup>139</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e E. M., faqja 39; Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 18;

<sup>140</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 35 to faqja 36;

<sup>141</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 23;

<sup>142</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 3 to faqja 4; Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 36;

<sup>143</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 3 to faqja 4;

<sup>144</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e E. M., faqja 41 to faqja 42;

<sup>145</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 33; Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 6;

<sup>146</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 10;

<sup>147</sup> Document 360 from Prosecution file; See also Document 163 from Police file;

D. V. konfirmoi para gjykatës se ai e pa atë dokument në atë kohë dhe kuptoi nga ky dokument se kamioni ishte ngarkuar me lëndë djegëse<sup>148</sup>. Në intervistën e tij në procedurën paraprake ai deklaroi se besonte që *"lënda djegëse brenda automjetit ishte [e Z. V.] dhe qëllimi ishte të transportohej në pompën e tij të gazit"*<sup>149</sup>. Ai e konfirmoi këtë deklaratë në shqyrtimin gjyqësor<sup>150</sup>. Për më tepër, dëshmitari D. V. deklaroi më tej se ai mendonte se ishte *"e pazakontë"* që holluesi të nisej drejt një pompe gazi<sup>151</sup>. Edhe pse u përball me elemente të shumta të dyshimta, dëshmitari D. V., i cili ishte në pozitë autoriteti, nuk bëri asnjë përpjekje për të kontrolluar përmbajtjen e ngarkesës së kamionit, dhe as ligjshmërinë e ngarkesës së transportuar nga kamioni<sup>152</sup>. Megjithatë, ai deklaroi para gjykatës se ishte detyrë e tyre, si oficerë policie, të kontrollonin dokumentacionin dhe mallrat në raste të tilla<sup>153</sup>. Megjithëse e kontrolloi dokumentacionin, dëshmitari D. V. nuk kontrolloi natyrën dhe sasinë e mallit të transportuar, edhe pse ngarkesa ishte e dyshimtë. Sapo Stacioni i Policisë së Zveçanit mori përsipër rastin, kamioni u lirua krejt nga mbikëqyrja e policisë dhe nuk u dërgua në terminalin doganor<sup>154</sup>. Megjithëse dëshmitari A. J. dëshmoi se në fund dokumentacioni doganor i kamionit u dërgua në Stacionin Policor të Zveçanit nga vetë shoferi në arrati i kamionit<sup>155</sup>, Trupi Gjyqësor nuk e vlerëson të besueshëm këtë version të fakteve<sup>156</sup>.

109. Një pasojë e tretë e marrjes përsipër të rastit nga ana e Stacionit Policor të Zveçanit është se motoçikleta nuk u sekuestrua nga Policia<sup>157</sup>.
110. Megjithatë, Trupi Gjyqësor gjen se nuk mund të vërtetohet se i Akuzuari e përdori automjetin e tij me dashje si armë vdekjeprurëse, me qëllim që të vriste të dëmtuarit (**FAKTI I PAPROVUAR nr. I**). Trupi Gjyqësor gjithashtu gjen se nuk mund të vërtetohet se i Akuzuari e parashikoi mundësinë e goditjes dhe të vrasjes së tyre nga veprimi i tij dhe se ai u pajtua me këtë (**FAKTI I PAPROVUAR nr. II**).
111. Ndërsa voziste motoçikletën e tij, i akuzuari kishte një pasagjer në pjesën e pasme<sup>158</sup> dhe kishte veshur rroba normale<sup>159</sup>. Nëse ai kishte për qëllim ta

<sup>148</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 11;

<sup>149</sup> Shih Marrjen në Pyetje në Procedurën Paraprake të Dëshmitarit D. V., shih Tabelën 13, Dosja e Gjykatës, PROCEDURA PARAPRAKE, VËLLIMI II;

<sup>150</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 11;

<sup>151</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 11 and faqja 13;

<sup>152</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 13;

<sup>153</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 22;

<sup>154</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 19; Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 21; Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 13;

<sup>155</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 39;

<sup>156</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. J., faqja 42 to faqja 43;

<sup>157</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 10 qershor 2014, Dëshminë e D. V., faqja 24;

<sup>158</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 03 qershor 2014, Dëshminë e A. T., faqja 9;

përdorte mjetin e tij si armë vdekjeprurëse, me qëllim që të vriste oficerët e policisë, mund të supozohet se ai do të kishte përdorur një mënyrë tjetër e jo thjesht të voziste një automjet të hapur në drejtim të tyre, pa mbrojtje, të tillë si kokorja, dhe një person tjetër në pjesën e pasme të automjetit të tij (**FAKTE TË PAPROVUARA nr. I dhe II**).

112. Për më tepër, pasi i kaloi të dëmtuarit, të cilëve iu desh të largohen shpejt mënjanë për të shmangur përplasjen, por pa ekzekutuar asnjë lëvizje *in extremis*, i Akuzuari ekzekutoi më pas një kthesë U dhe e ndaloi motoçikletën e tij në afërsi të kamionit. Siç ka deklaruar i Akuzuari, nëse ai do të përpiquej t'i privonte nga jeta dy oficerët e policisë, ai nuk do të ishte kthyer<sup>160</sup>. Përveç kësaj, provat vërtetojnë se i Akuzuari u përpoq t'i afrohej kamionit në drejtimin ku po qëndronin oficerët e policisë ROSU. Kjo përsëri tregon se i Akuzuari kishte për qëllim t'i afrohej kamionit, megjithëse kamioni ishte nën mbikëqyrjen e policisë. Dëshmitari A. B. i tha Gjykatës se i Akuzuari "*me siguri mendonte se asnjë oficer policie nuk mund ta arrestonte*"<sup>161</sup>. Kjo konfirmohet nga dëshmia e dëshmitarit Ç. S., i cili deklaroi se në afërsi të vendngjarjes një turmë ishte mbledhur sepse "*policia arrestoi Z. V.*" dhe "*njerëzit ishin të shqetësuar*"<sup>162</sup>. Duke qenë në veri të Kosovës, i Akuzuari mund të ketë ndjerë një pozitë të caktuar autoriteti dhe një ndjenjë sigurie, meqë i Akuzuari njihet mirë nga popullata që ndodhet atje (**FAKTI I PAPROVUAR nr. I**).
113. Provat tregojnë gjithashtu se i Akuzuari nuk e zbatoi urdhrin e oficerit të policisë për të ngadalësuar dhe ndaluar. Siç u tha nga dëshmitari A. B., "*kur një person nuk i bindet një rregulli/urdhri të policisë, është e qartë se ky person ka për qëllim të sulmojë një zyrtar në kryerjen e detyrës*"<sup>163</sup>. Duhet të theksohet se megjithëse nuk e ngadalësoi vozitjen, i Akuzuari nuk e rriti shpejtësinë e automjetit ndërsa iu afrua të dëmtuarve. Dy oficerëve të policisë iu desh të largohen mënjanë për të shmangur përplasjen me motoçikletën, dhe ata e bënë këtë me lehtësi të dukshme (**FAKTET E PAPROVUARA nr. II**).

## II. GJETJET LIGJORE

114. Trupi gjykues nuk është i detyruar t'i përmbahet kualifikimit ligjor të veprës penale ashtu siç është parashtruar në Aktakuzën e Prokurorisë, në bazë të nenit 360 paragrafi (2) të KPP-së.

---

<sup>159</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e S. G., faqja 27;

<sup>160</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 19 qershor 2014, Dëshminë e të Akuzuarit, faqja 6;

<sup>161</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 6;

<sup>162</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 11 qershor 2014, Dëshminë e Ç. S., faqja 7;

<sup>163</sup> Shih proces-verbalin e seancës së datës 09 qershor 2014, Dëshminë e A. B., faqja 10;



115. Trupi Gjykues me këtë rast i referohet Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 25 prill 2013, në të cilin Gjykata e Apelit konstatoi se *"në bazë të nenit 386 (2) të KPPK-së, Gjykata e Shkallës së Parë nuk ishte e detyruar t'u përmbahej propozimeve të prokurorit në lidhje me klasifikimin ligjor të veprës. Kështu që, ri-klasifikimi ligjor i akuzës së parë nga Krim i Organizuar në Mashtrim në vetvete nuk përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase kjo mundësi parashikohet në mënyrë të qartë nga kodi procedural"*<sup>164</sup>. Më tej, Gjykata e Apelit vendosi se *"praktika gjyqësore e vendosur e Gjykatës Supreme të Kosovës është që, kur procedon me një ri-klasifikimin sipas nenit 386 të KPPK-së, Trupi Gjykues duhet të sigurohet që i akuzuari të njoftohet për këtë ri-klasifikim në kohën e duhur"*<sup>165</sup>.
116. Prandaj, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) gjeti se neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ishte shkelur kur karakterizimi ligjor i fakteve ishte ndryshuar pa i dhënë Mbrojtjes mundësinë e paraqitjes së vërejtjeve. Në të vërtetë, mbrojtjes duhet t'i jepet *"mundësia e ushtrimit të të drejtave të saj të mbrojtjes lidhur me këtë çështje në mënyrë praktike dhe të efektshme dhe, në veçanti, brenda afatit"*<sup>166</sup>. Kjo përfshin të drejtën e mbrojtjes për t'u informuar në mënyrë të hollësishme lidhur me natyrën dhe shkakun e akuzës të ngritur kundër të Pandehurit, si dhe të drejtën e mbrojtjes për të pasur kohë dhe kushte të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e saj<sup>167</sup>.
117. Pasi dëgjoi dëshmitë në këtë lëndë, Trupi Gjykues e informoi Prokurorinë dhe Mbrojtjen më 9 korrik 2014 se Trupi Gjykues mund ta riklasifikojë sipas detyrës zyrtare akuzën fillestare në një akuzë tjetër, bazuar në fakte që nuk përkrijnë tërësisht me ato të përshkruara në Aktakuzë, por të cilat nuk konfigurojnë një ndryshim thelbësor të rrethanave. Për rrjedhojë, Trupi Gjykues e informoi Mbrojtjen se Gjykata mund të gjente elemente të veprës penale të "pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare", në shkelje të nenit 316, paragrafi (1), paragrafi (2) dhe paragrafi (3), të KPK-së.
118. Trupi Gjykues e informoi Mbrojtjen në afat, pasi që Gjykatës iu desh të dëgjojnë të gjitha dëshmitë dhe provat e sjella në shqyrtim gjyqësor para se të vlerësonte sipas detyrës zyrtare ri-klasifikimin e mundshëm të veprës penale fillestare.

<sup>164</sup> Gjykata e Apelit, Aktvendim lidhur me Ankesën, PAKR 1122/2012, Aktgjykim i datës 25 prill 2013, paragrafi 12;

<sup>165</sup> Gjykata e Apelit, Aktvendim lidhur me Ankesën, PAKR 1122/2012, Aktgjykim i datës 25 prill 2013, paragrafi 12; Shih Supreme Court of Kosovo, Ap-Kz no. 61/2012, Aktgjykim i datës 02 tetor 2012, paragrafi 29; Shih gjithashtu International Criminal Court, ICC-01/04-01/07-3319, Decision on the implementation of regulation 55 of the Regulations of the Court dhe severing the charges against të Akuzuarit persons, 21 November 2012, paragrafi 37;

<sup>166</sup> GJEDNJ, *Pélissier dhe Sassi kundër Francës*, Ank. nr. 25444/94, Aktgjykim i datës 25 mars 1999, paragrafi 62;

<sup>167</sup> GJEDNJ, *Mattei kundër Francës*, Ank. nr. 34043/02, Aktgjykim i datës 19 dhjetor 2006, paragrafi 43;

119. Në të njëjtën ditë, Trupi Gjykses i dha Mbrojtjes mundësinë të paraqiste së ndonjë vërejtje dhe të paraqiste ndonjë dëshmi a provë shtesë në lidhje me këtë ri-klasifikim të mundshëm, në përputhje me kërkesën e Gjykatës së Apelit, të përcaktuar në vendimin e saj të datës 25 prill 2013, si dhe në përputhje me praktikën gjyqësore që buron nga GJEDNJ.
120. Më 9 korrik 2014, Mbrojtja e informoi Gjykatën se nuk dëshironte të paraqiste ndonjë dëshmi a provë shtesë lidhur me këtë ri-klasifikim të mundshëm të akuzës penale fillestare dhe se ajo do t'i paraqesë vërejtjet e saj mbi këtë çështje gjatë fjalës së saj përfundimtare. Mbrojtja e paraqiti fjalën përfundimtare të saj në Gjykatë më 9 korrik 2014.
121. Krahas kësaj, në bazë të KPRK të ri, supozimi është se do të vazhdojë të zbatohet dispozita në fuqi në kohën e veprës penale, përveç nëse një dispozitë e re është më e favorshme për të pandehurin, sipas Nenit 3 paragrafët (1) dhe (2). Trupi Gjykses i mori parasysh ato dispozita kur vlerësoi në radhë të parë elementet thelbësore të veprës penale, por edhe nivelin dhe llogaritjen e ndonjë dënimi të lidhur me të.

### **3.1. Vrasja e rëndë në tentativë**

#### **Kualifikimi ligjor**

122. Aktakuza e Prokurorisë e ngarkon të Akuzuarin me veprën penale të "vrasjes së rëndë në tentativë", në kundërshtim me nenin 147 paragrafi (1.10) në lidhje me nenin 20 të KPK-së, lidhur me tentativën për të privuar nga jeta Avni Tahirin dhe Fitim Salihun.
123. Neni 20 Paragrafi (1) i KPK-së e përkufizon "tentativën" si më poshtë: *"Kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale."*
124. Tentativa nënkupton mungesën e përfundimit të plotë të veprës. Sipas ligjit, është pritshmëria e rrjedhës së veprimeve të kryerësit ajo që përcakton aktin në tentativë.
125. Është e qartë se elementet e cekuara të veprës penale janë elementet aktive të veprës penale dhe jo elementet mendore. *Mens Rea* që kërkohet për veprën e plotë duhet të përmbushet gjithmonë në mënyrë që të kemi tentativë: në anën njohëse, qëllimi i personit duhet të mbulojë të gjitha elementet e veprës penale, duke përfshirë edhe kriteret që e rrisin dënimin; në anën e dashjes, personi duhet të ketë shkallën e duhur të qëllimit të kërkuar nga vepra në fjalë.

126. Neni 146 i KPK-së e përkufizon "vrasjen" kështu:  
*"Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta [...]"*.
127. *Actus reus* i vrasjes përfshin elementet e sjelljes dhe rezultatit: shkaktimin e vdekjes së një qenie tjetër njerëzore.
128. Elementi mendor i kësaj vepre kërkon qëllimin siç përcaktohet në nenin 15 të KPK-së.
129. Vrasja dhe vrasja e rëndë duhen konsideruar në një lidhje mes normave themelore dhe atyre të cilësuar. Këto të fundit janë një formë e rëndë dhe jo një vepër e veçantë, siç tregohet në nenin 147 të KPK-së lidhur me një person i cili është vrasësi (i cili ka privuar në rrethana të caktuara një person tjetër nga jeta e tij). Si e tillë, lidhur me nenin 146 të KPK-së, vrasja e rëndë është kryer në qoftë se njëri nga faktorët rëndues të përmendur në nenin 147 të KPK-së është i pranishëm në veprën penale.
130. Ky mund të marrë formën e një elementi mendor apo të një pozicioni thjesht faktik. Në këtë lëndë Trupi Gjykes mori në konsideratë Nenin 147 pika (10):  
*"(10) Privon nga jeta personin tjetër zyrtar gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në mbrojtje të rendit ligjor, sigurimit të njerëzve apo të pasurisë (...) ose ruajtjes së rendit dhe të paqes publike"*.

### **Përgjegjësia penale**

131. Siç u përmend, aktakuza e ngarkon të akuzuarin me "vrasje të rëndë në tentativë".
132. Pas vlerësimit të të gjitha fakteve si më sipër, Gjykata konstatoi se kualifikimi ligjor i "vrasjes në tentativë" nuk mund të zbatohet.
133. Në rastin në fjalë, u provua se i Akuzuari voziti një motoçikletë në drejtim të punonjësve të Policisë A. T. dhe F. S. (**FAKTI nr. XVI**), të cilët mundën të shmangnin përplasjen me automjetin që po vinte drejt tyre vetëm duke u larguar shpejt mënjanë (**FAKTI nr. XVII**). Të dy oficerët e Policisë mbetën kështu të padëmtuar dhe nuk ndodhi asnjë vdekje si pasojë e veprimeve të të Akuzuarit. Është e qartë se nuk u krye një vepër e plotë e vrasjes.
134. Atëherë duhet të shqyrtohet dashja e të Akuzuarit.
135. Që një akt të konsiderohet si tentativë për të kryer krim, duhet të ketë një veprim me dashje - me dashje direkte ose eventuale - dhe veprim të menjëhershëm për kryerjen e veprës penale, në pajtim me nenin 20 paragrafi (1) të KPK-së.

136. Gjykata e gjeti të paprovuar faktin se i akuzuari kishte ndonjë dashje për të privuar nga jeta të dëmtuarit A. T. ose F. S.. Nuk u provua se veprimi i të akuzuarit, megjithëse mbante rrezikun e shkaktimit të lëndimeve kërcënuese për jetën, kishte për qëllim vrasjen e të dëmtuarve. Prandaj, kualifikimi ligjor i "vrasjes në tentativë" nuk mund të qëndrojë.
137. Meqenëse nuk u gjetën elementet që e përcaktojnë këtë veprë penale në ligjin në fuqi në kohën e kryerjes së akteve, është e tepërt të analizohen se cilat janë elementet përbërëse të kësaj vepre në KPRK-në e ri, meqë, siç thuhet në § 121 më sipër, "*Ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale*".

### **3.2. Pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare**

#### **Kualifikimi ligjor**

138. Gjykata, megjithatë, nuk është e detyruar të pranojë kualifikimin ligjor të përcaktuar nga Prokurori në aktakuzë, siç përmendet në §§ 114, 115, 116 më sipër. Kjo do të thotë se gjykata mund ta rikualifikojë veprën penale të përcaktuar në aktakuzë nëse këtë e mbështesin faktet e provuara.
139. Neni 316 i KPK-së përkufizon veprën penale të "pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare" dhe përcakton:  
*"(1) Kushdo që me dhunë apo me kanosje për përdorim të atqasshëm të dhunës, pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare që bie në fushëveprimtarinë e kompetencave të tij (...) dënohet (...).*  
*(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është kryer ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave të sigurimit publik, të sigurisë së Kosovës apo të ruajtjes së rendit publik, burgosjes së kryerësit të veprës penale apo të ruajtjes së personit të privuar nga liria, kryerësi dënohet (...).*  
*(4) Tentativa për kryerjen e veprës penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni dënohet".*

#### **Përgjegjësia penale**

140. Gjykata gjeti se elementet objektive të veprës penale bazë janë përmbushur. I Akuzuari, më 14 gusht të vitit 2010, arriti të depërtojë përmes një perimetri të vendosur nga forcat e policisë rreth një kamioni të ndalur në rrjedhën e një operacioni policor që kishte për qëllim ndalimin e kontrabandës së paligjshme të mallrave. Ai e bëri këtë duke ngarë një motoçikletë drejt oficerëve të policisë të cilëve iu desh të largoheshin menjëherë me shpejtësi për të shmangur

përplasjen me automjetin që po shkonte drejt tyre (**FAKTET nr. I, II, XI, XII, XVI dhe XVII**).

141. Përdorimi i forcës nga i pandehuri në një mënyrë të aftë për të krijuar rrezik për lëndim trupor apo më keq është vërtetuar në mënyrë të qartë nga përdorimi i një objekti të fortë e me madhësi të konsiderueshme në lëvizje drejt një trupi njeriu.
142. Elementi pengues në veprimet e të Akuzuarit nuk u përfundua dhe për këtë arsye vepra cilësohet si tentativë (shih më lart §§ 124, 125, 133).
143. Neni 316 paragrafi (4) i KPK-së e dënon pengimin në tentivë, që është në pajtim me nenin 20 paragrafi (2) të të njëjtit Kod.
144. I Akuzuari kishte për qëllim të parandalonte marrjen në doganë dhe nënshtrimin ndaj procedurave doganore të kamionit së bashku me ngarkesën e transportuar (**FAKTI nr. XX**). Ai nuk arriti ta bënte këtë ngase u arrestua menjëherë pasi ndaloi motoçikletën pranë kamionit.
145. Është i parëndësishëm fakti që kamioni nuk u dërgua asnjëherë në terminalin doganor dhe më vonë iu rikthye shoferit (shih më sipër § 108). Kjo ka ndodhur jo për shkak të veprimeve të të pandehurit, por për shkak se kështu vendosën palët e treta të cilët kishin autoritet ta bënin këtë.
146. Pas vërtetimit të veprës penale të kryer (*actus reus*), Trupi Gjykses iu kthye më pas vlerësimit nëse mund të vërtetohen elementet subjektive (të ashtuquajturat *mens rea*) të të pandehurit.
147. Në bazë të nenit 11 paragrafi (1) të KPK-së, "*Personi konsiderohet penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe është shpallur fajtor për kryerjen e një vepre penale.*" Në bazë të të njëjtës dispozite, "*Personi është fajtor për kryerjen e një vepre penale në rast se ai e kryen veprën penale me dashje apo nga pakujdesia.*"
148. Dy janë, pra, elementet që duhet të vlerësohen: aftësia mendore e personit dhe dashja për të kryer ose pakujdesia në kryerjen e një vepre penale.
149. Së pari, nuk ka dyshim për faktin se i akuzuari ishte plotësisht i aftë mendërisht gjatë kohës kritike. Në fakt, kjo çështje nuk ka qenë asnjëherë subjekt i argumentimit gjatë procedurës.
150. Së dyti, Trupi Gjykses duhej të vlerësonte nëse, kur kreu veprën penale të përcaktuar më lart, i akuzuari veproi me dashje. Ligji kërkon qëllimin si formë të *mens rea* para se të përcaktohet përgjegjësia penale, pasi neglizhenca përbën përjashtim sipas nenit 11 paragrafi (3) të KPK-së.

151. Neni 15 i KPK-së, kur përshkruan konceptin e qëllimit, thekson se:  
*"(1) Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale.  
 (2) Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj.  
 (3) vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj".*
152. Trupi gjykues konstatoi se përkufizimi i dashjes direkte është i qartë: një person duhet të dijë se ai ose ajo është duke bërë diçka dhe dëshiron të bëjë këtë. Me fjalë të tjera, ky person duhet të ketë dijeni elementet e veprës (elementin njohës) dhe të ketë vullnetin për ta përfunduar (elementi i dashjes).
153. U provua se i akuzuari ka qenë plotësisht i vetëdijshëm dhe ka parashikuar që, me veprimet e tij, ai do t'i pengonte punonjësit e policisë – për të cilët ai kishte dijeni se po vepronin në cilësinë e tyre zyrtare (**FAKTI nr. XX**) – të dërgonin kamionin në terminalin doganor. Duke dashur ta bëjë këtë, ai ka vepruar me dashje direkte. Përfundimi është se, në anën subjektive, i akuzuari kishte *mens rea*-n e kërkuar për veprën e plotë.
154. Rrethana rënduese e paraparë në nenin 316 paragrafi (3) të KPK-së është gjithashtu e pranishme: personat zyrtarë ndaj të cilëve veproi i akuzuari po ruanin sigurinë dhe rendin publik. U vërtetua që personat zyrtarë që po kryenin detyrat zyrtare, oficerët e policisë A. T. dhe F. S., po ruanin paqen publike dhe po kontrollonin një zonë të hapur, ku po zhvillohej një operacion policor zyrtar dhe i miratuar dhe që po përballej me armiqësinë e njerëzve që ishin mbledhur atje të shumtë në numër për të protestuar kundër pranisë së autoriteteve publike të cilat ata i konsideronin si të paligjshme (**FAKTET nr. I, II, VI, VIII, XX**)
155. *Mens rea* e të akuzuarit e mbulon edhe këtë element që rrit dënimin; ai ishte në dijeni se ata ishin oficerë policie që po vepronin si të tillë.
156. Kështu, Trupi Gjykues e gjen të akuzuarin fajtor dhe penalisht përgjegjës për veprën penale jo të plotë të "pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare", sipas nenit 316 paragrafët (1) dhe (4) të KPK-së dhe në rrethana rënduese sipas paragrafit (3) të të njëjtit nen.
157. KPRK i ri dënon gjithashtu "pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare", në nenin 409. Këtu ai përcakton:  
*"(1) Kushdo që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet...".  
 "(5) Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj gjyqtarit, prokurorit, zyrtarit të gjykatës, zyrtarit të prokurorisë apo personit të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria zyrtarit policor, zyrtarit doganor, zyrtarit ushtarak*

*apo zyrtarit të shërbimit korrektues gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare, kryesi dënohet ...".*

158. Ndryshimet e vetme të rëndësishme të përfshira në krahasim me KPK-në, përveç kufijve të rinj të ndëshkimit, janë si më poshtë: tani tentativa parashihet në përshkrimin bazë të vetë veprës; faktorët rëndues tani përshkruajnë kategoritë e personave zyrtarë me mbrojtje të posaçme, në krahasim me specifikimin shprehimisht të funksioneve të mbuluara, si më parë.
159. Kjo do të thotë se elementet kryesore të veprës penale mbeten të njëjta në KPRK si në KPK. Kjo do të thotë gjithashtu se i akuzuari është fajtor edhe sipas nenit 409 paragrafët (1) dhe (5) të KPRK-së.

### III. CAKTIMI I DËNIMIT

160. Kur shqipton sanksionin penal, Gjykata duhet të marrë parasysh edhe qëllimin e përgjithshëm të dënimit, domethënë, ndalimin e aktiviteteve të rrezikshme shoqërore, duke i frenuar të tjerët nga kryerja e veprave të ngjashme penale, dhe qëllimin e vecantë, që është parandalimi i kryerësit nga përsëritja e veprës penale. Sipas nenit 34 të KPK-së: "*Qëllimet e dënimit janë: 1) Të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; dhe 1.2 "Të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale". Neni 41 i KPRK-së shton si qëllim të dënimit: "1.4 të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit". Duke pasur këtë parasysh, Trupi Gjykues vendosi si në vijim.*
161. Bazuar në atë që thuhet në § 121 më sipër në lidhje me hyrjen në fuqi të Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës nga 1 janari 2013, dhe duke marrë parasysh parimin e zbatueshmërisë së detyrueshme të *lex mitior*<sup>168</sup>, Trupi Gjykues duhet të vlerësojë *in concreto* se çfarë ligji do të ishte më i favorshëm për të akuzuarin, duke marrë parasysh karakteristikat e tij, natyrën e veprës penale dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra<sup>169</sup>. Prandaj, *lex mitior* duhet gjetur *in concreto*<sup>170</sup>.

#### **4.1. Llogaritja e dënimit sipas KPK-së së vjetër**

<sup>168</sup> Shih GJEDNJ, *Scoppola kundër Italisë* (nr. 2), Ank. nr. 10249/03, 17 shtator 2009;

<sup>169</sup> Shih GJEDNJ, *Scoppola kundër Italisë* (nr. 2), Ank. nr. 10249/03, Aktgjykim i datës 17 shtator 2009, paragrafi 109; GJEDNJ, *Maktouf dhe Damjanovic kundër Bosnjës dhe Herzegovinës*, separate opinions, faqja 43;

<sup>170</sup> Shih më lart, GJEDNJ, *Maktouf dhe Damjanovic kundër Bosnjës dhe Herzegovinës*, faqja 44;

162. Në lidhje me veprën penale të "pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare", Neni 316 paragrafi (4) i KPK-së parashikon që tentativa e veprës penale në Nenin 316 paragrafi (1) dënohet.
163. Neni 20 paragrafi (3) i KPK-së parasheh se *"Personi që tenton të kryejë vepër penale dënohet më butë se sa kryerësi, në pajtim me nenin 65(2) të këtij Kodi"*. Neni 65 Paragrafi (2) i KPK-së parasheh se *"Dënimi i shqiptuar për tentativë [...]nuk duhet të jetë më i lartë se tri të katërtat e maksimumit të dënimit të paraparë për vepër penale"*.
164. Neni 316 paragrafi (3) i KPK-së parasheh një dënim me **tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet burgim** për veprën penale për të cilën i akuzuari është fajtor.
165. Duke marrë parasysh Nenin 20 paragrafi (3) dhe Nenin 65 paragrafi (2) të KPK-së dhe duke vënë në dukje se dënimi maksimal i paraparë në KPK për pengimin e rëndë të "pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare" është pesë (5) vjet burgim, Trupi Gjykses vlerësoi se dënimi maksimal për tentativën është dënimi me **tre (3) vjet e nëntë (9) muaj burgim**.
166. Sipas Neni 64 paragrafi (1) të KPK:  
*"Gjykata e cakton dënimin për vepër penale brenda kufijve të paraparë me ligj për atë vepër penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rëndimin e dënimit (rrethanat lehtësuese dhe rënduese) dhe sidomos shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, pranimin e fajit, rrethanat e tij personale të kryerësit dhe sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me veprën si dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit"*.
167. Sa u përket rrethanave lehtësuese për të akuzuarin **Z. V.**, Trupi Gjykses gjeti se në këtë lëndë nuk pati rrethana lehtësuese.
168. Sa u përket rrethanave rënduese për të akuzuarin **Z. V.**, Trupi Gjykses mori parasysh faktet e mëposhtme si të tilla: vepra penale ndodhi në veri të Kosovës, ku sundimi i ligjit nuk ka qenë gjithmonë i pranishëm, patenta e fortë në veri të Kosovës e kontrabandës së paligjshme të mallrave, imazhi i autoritetit të punonjësve shqiptarë të policisë së Kosovës në veri të Kosovës, që ishte i dëmtuar, perceptimi publik i incidentit dhe se i Akuzuari besonte se kishte ndjenjën e pushtetit në atë pjesë të Kosovës dhe e përdori atë në favor të tij.
169. Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e përmendura më lart, Trupi Gjykses do të vendoste kundër të pandehurit **Z. V.** dënimin me **dymbëdhjetë (12) muaj burgim**.



170. Pastaj Gjykata shqyrtoi dënimet alternative të parashikuara në Nenin 41 të KPK-së. Ajo arriti në përfundimin se asnjë prej këtyre dënimeve nuk do t'i përmbushte qëllimet e dënimit të përcaktuara në Nenin 34 të KPK-së, veçanërisht qëllimin e përgjithshëm të frenimit. Veprimet e të akuzuarit demonstrojnë se ai veproi në kundërshtim me ligjin dhe me një ndjenjë të pandëshkueshmërisë duke pritur për të përfituar nga koha dhe vendi ku ai veproi, domethënë, nga prania e një turme të serbëve të Kosovës, armiqësore ndaj Policisë së Kosovës që vepronte atje për të ndaluar disa aktivitete kriminale. Ekzekutimi i dënimit shërben për të treguar se veprimet kriminale nuk duhet të tolerohen dhe se sundimi i ligjit është i zbatueshëm, pavarësisht nga zona ku kryhet krimi.

#### **4.2. Llogaritja e dënimit sipas KPRK të ri**

171. Në lidhje me veprën penale të tentativës së "pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare", Neni 409 paragrafi (5) i KPRK-së parasheh një dënim prej **një (1) viti deri në pesë (5) vjet burgim**, kur vepra e parashikuar në paragrafin (1) të dispozitës është kryer kundër një oficeri të policisë.

172. Neni 28 paragrafi (3) i KPRK-së parasheh që "*Personi që tenton të kryejë veprë penale dënohet si të kishte kryer veprën penale, por dënimi mund të zbutet*".

173. Në krahasim me Kodin e mëparshëm, zbutja e dënimit për veprat e papërfunduara nuk është shkaktuar automatikisht, por, në vend të kësaj, është një opsion që merr parasysh qëllimin e dënimeve. Prandaj, testi i parë me të cilin përballet Trupi Gjykes është nëse ta zbusë dënimin apo jo. Trupi Gjykes vlerëson se ndjenja e pandëshkueshmërisë me të cilën veproi i Akuzuari në mes të ditës para një turme nuk lejon ndonjë zbutje të mundshme, sepse arsyet e parandalimit të përgjithshëm dhe të veçantë parandaluese këshillojnë kundër kësaj zbutjeje.

174. Në bazë të të njëjtave rrethana rënduese, Trupi Gjykes do të kishte shqiptuar kundër të akuzuarit **Z. V.** dënimin me **18 (tetëmbëdhjetë) muaj burgim**, sipas KPRK-së.

175. Gjykata përsëri shqyrtoi dënimet alternative të parashikuara në nenin 49 të KPRK-së. Ajo arriti në përfundimin se asnjë prej këtyre dënimeve nuk do të plotësonte qëllimet e dënimit të përcaktuara në Nenin 41 të KPRK-së, për arsyet e përmendura më lart (shih §169).

#### **4.3. Lex mitior dhe llogaritja përfundimtare**

176. Trupi Gjykes vlerëson se duke zbatuar KPK-në e vjetër, rezultati më i favorshëm për të akuzuarin **Z. V.** do të arrihej *in concreto*.

177. Prandaj, në lidhje me të Akuzuarit **Z. V.**, Trupi Gjykses caktoi dënimin me dymbëdhjetë (12) muaj burgim për veprën penale të tentativës për të "penguar personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare", në pajtim me Nenin 38 paragrafi (1), Nenin 65 paragrafi (2) dhe Nenin 316 paragrafët (1), (3) dhe (4) të KPK-së.
178. Koha e kaluar në paraburgim nga 29 korriku 2013 deri më 28 shkurt 2014 dhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak prej 28 shkurtit 2014 deri më 20 qershor 2014 duhet të përfshihen në dënimin me burgim, në pajtim me Nenin 73 paragrafët (1) dhe (4) të KPK-së.

## **V. LIGJI PËR AMNISTINË**

179. Sipas nenit 2 paragrafi (1) të Ligjit për Amnistinë (Ligji nr 04/L-209.):  
*"gjithë kryesve të veprave penale të listuara në nenin 3 të këtij ligji të cilat janë kryer para datës 20 qershor 2013 u jepet lirim i plotë nga ndjekja penale apo nga ekzekutimi i dënimit, në përputhje me kushtet e parapara me nenin 3 të këtij ligji".*
180. Trupit Gjykses iu desh të vlerësojë nëse Ligji për Amnistinë është i zbatueshëm në këtë lëndë pasi që vepra penale është kryer para 20 qershorit 2013.
181. Neni 3 i Ligjit për Amnistinë liston veprat penale që përjashtohen plotësisht nga ndjekja penale apo nga ekzekutimi i dënimit.
182. Neni 3 paragrafi (1) nën-paragrafi (1.1.13) parashikon përjashtimin për veprën penale të "pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 409, paragrafët (1), (2) dhe (3))" kur vepra është kryer me qëllim të kryerjes së veprës penale të "thirrjes për rezistencë".
183. Trupi Gjykses gjeti se, në këtë lëndë, Ligji për Amnistinë nuk zbatohet sepse vepra penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, nuk është kryer me qëllimin për të kryer veprën penale të "thirrje për rezistencë".

## **VI. KOSTOT DHE KËRKESË-PADIA PËR KOMPENSIM**

### **6.1. Shpenzimet e procedurës**

184. Trupi Gjykses e gjeti fajtor të Akuzuarin **Z. V.** dhe, në pajtim me nenin 453 paragrafi (1) të KPP-së, i Akuzuari do të paguajë shpenzimet e procedurës penale. Duke marrë parasysh numrin e seancave të mbajtura dhe

kushtet ekonomike të të Akuzuarit, Trupi Gjykues vendosi se i Akuzuari duhet të paguajë treqind (300) euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale, por lirohet nga detyrimi për të paguar shpenzimet e tjera, në pajtim me nenin 453 paragrafi (4) të KPP-së.

185. I Akuzuari do ta paguajë shumën e urdhëruar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita kur Aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

## **6.2. Kërkesë-padia për kompensim të dëmit**

186. Trupi Gjykues nënvizon se të dëmtuarit nuk paraqitën kërkesë-padi për kompensim të dëmit gjatë periudhës së shqyrtimit gjyqësor

### **Gjykata Themelore e Mitrovicës**

**Nuno de Madureira**

**Roxana Comsa**

**Iva Niksic**

**Kryetar i trupit gjykues**

**Anëtar i trupit gjykues**

**Anëtar i trupit gjykues**

**Vera Manuello**

**Proces- mbajtës**

**MJET JURIDIK:** I pandehuri, mbrojtësi ligjor i tij, prokurori ose i dëmtuari brenda 15 ditëve nga dorëzimi tek ta të këtij Aktgjykimi mund të paraqesin ankesë në bazë të neneve 380 paragrafi (1) dhe 381 paragrafi (1) të KPP-së. Çdo ankesë duhet të paraqitet në gjykatën e shkallës së parë, në bazë të nenit 388 paragrafi (1) të KPP-së.